

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7799 E enjte 21 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje **në** Reporter.al
Në orët e pasdites së 17 tetorit, një grup oficerësh të maskuar të Forcës Operacionale të Policisë së Shtetit, u futën me pistoletë në duar në një dhomë ...
Vijon në faqen 20

Nga BESAR LIKMETA
"Forca e Ligjit," shqiptare apo e huaj?


Opinion **i** Ditës
Opozita konstruktive e një vendi renditet ndër vlerat parësore dhe më absolute që një sistem demokratik mund të japë. Si qytetar, pres që opozita e vendit tim ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Beteja për integrimin




Koncesionari, penalizim shtesë për ndërtuesit

Tarifa "e fshehur" në Sharrë, reagojnë bizneset: Ky është një vendim korruptiv

Luan Bregasi: Tenderi i landfillit, pa konkurrencë.
Luigj Aleksis: Gjobë po u derdhën dherat diku tjetër


Bizneset reagojnë kundër kontratës me Partneritet Publik Privat që operon në zonën e Sharrës. Pas publikimit nga "News 24" të aferës me tarifën shtesë, që ndërtuesit duhet t'i paguajnë koncesionarit të Sharrës, kanë reaguuar "Biznes Albania" dhe Shoqata e Ndërtuesve. Ata e cilësojnë këtë, një vendim me natyrë klienteliste dhe korruptive. Kreu...

Në faqen 7

PD-LSI FIRMOSIN DOREHEQJET: BETEJE DERI NE FUND PER ZGJEDHJE TE LIRA

BASHA-KRYEMADHI NE UNISON, DJEGIN MANDATET E DEPUTETEVE

Këshilli Kombëtar i PD miraton me konsensus largimin nga parlamenti. Sot protesta, opozita nuk tërhiqet: Dhuna gjendet në zyrën e Edi Ramës



(Në foto) Kryetarja e LSI Monika Kryemadhi. Kryetari i PD Lulzim Basha.

Në faqen 4

SHENDETESI

Zbardhen emrat e 206 fituesve në portalin "Infermierë për Shqipërinë"

Në faqen 10

MAXHORANCA

Gramoz Ruçi anulon seancën plenare, Kuvendi rrethohet me tela me gjemba

Në faqen 2

VENDIMI

Qeveria barazon gradat e ushtrisë me të policisë, si bëhet përshtatja

Në faqen 6

MINISTRJA E DREJTËSISE

Lirimi i Gert "Gjeneralit", Gjonaj pezullon drejtorin e burgut të Drenovës

Në faqen 9

GJERMANIA E MBESHTET



Meta, thirrje për reflektim: Opozita një, mazhoranca dy hapa prapa

Në faqen 5

Lista e dytë/ Ndërtimet pa leje, përfituesit e 'dëmshpërblimit' në Tiranë dhe në rrethe

Kompensimi, 750 pronarët që ndajnë 5 milionë dollarë

Formulari i aplikimit për përfitimin nga fondi financiar. 6 dokumentet që duhen dorëzuar

Publikohet lista me 750 pronarë që do të marrin kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZINI-t, përkatësisht në Tiranë



Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, fshatra turistike dhe Kamëz, Vorë. Refertuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m2 është 522 842 426,65 lekë. ATP ...

Në faqen 12-13

KRIZA POLITIKE PROTESTA

Opozita protestë para Kuvendit, mbi 1000 policë në terren

Policia e Shtetit: Protestuesit do tentojnë të hyjnë me forcë në Kuvend

Policia e Shtetit njoftoi dje se gjatë protestës së sotme, e paralizuar nga opozita, ka të dhëna sipas saj, për nxitje dhune dhe organizime me natyrë kriminale. "Nga informacionet e mbledhura nga shërbimet përkatëse, ka të dhëna për nxitje të dhunës dhe organizime me natyrë kriminale. Synohet hyrja me forcë në sallën e parlamentit, duke ushtruar dhunë mbi personelin që ka detyrimin ligjor të sigurojë mbrojtjen e institucionit themelor të demokracisë", thuhet në reagim. Në deklaratë, policia u bën thirrje organizatorëve që të distancohen hapur nga dhuna dhe të bëjnë thirrje për respektimin e ligjit nga çdo protestues. Po ashtu Policia e Shtetit u bën apel të gjithë atyre që



duan të ushtrjnë nesër lirinë e tubimit dhe të drejtën e protestës, që të mos përfshihen në asnjë rast e për asnjë arsye në veprime të dënueshme ligjërisht. "Policia e Shtetit e siguron opinionin publik, se forcat e rendit dhe sigurisë janë të gatshme t'i përgjigjen me

forcën e ligjit dhe në proporcionalitet të plotë, çdo veprimi të paligjshëm apo akti dhune. Po ashtu, janë marrë të gjitha masat për identifikimin dhe skedimin e çdo individi që do të evidentohet si shkelës i ligjit, si edhe për ndalimin e për nxjerrjen e çdo

shkelësi përpara drejtësisë", thuhet në reagim. Policia shprehet se do të bllokohen disa akse rrugore ku do të zhvillohet protesta, ndërsa do të zhvillohen kontrole përparëse të akteve rrugore kombëtare. Mësohet se mbi 1000 forca policie do të angazhohen në mbarrëvajtjen e kësaj proteste. Shpërndarja e uniformave blu pritet të jetë e ngjashme me protestën e së shunës. Përballë protestuesve me një kordon që do të jetë përgjatë gjithë rrethimit të parlamentit do të jenë punonjësit e rendit, ndërsa forcat Shqiponja dhe FNSH do të jenë në gatishmëri në bule-

vardin "Zhan Dark" dhe brenda rrethimit të xhamisë së Namazgjasë. Në gatishmëri pranë godinës së parlamentit do të jenë edhe Garda e Republikës, e cila në rast se nga ana e protestuesve do të ketë tentativa për të hyrë në parlament dhe për të bërë akte dhune do të përdorë gaz lotsjellës. Në gatishmëri pranë ambienteve të Parlamentit do të jenë dhe zjarfikëset dhe ambulancat. Kufizime për qarkullimin rrugor do të ketë tek "Xhorxh Bush" dhe pjesërisht në bulevardin "Zhan Dark". Autobusët, ashtu si protestën e shkuar, nuk do të lejohen në qytet. Të ardhurit nga veriu do ndalojnë tek "Asllan Rusi", kurse të ardhurit nga Jugut tek Ekonomiku.



Ish-kryeministri Berisha dje para selisë së PD-së

Vendimi pas lajmërimit të policisë se në protestën e sotme mund të sulmohet Kuvendi

Nisur nga informacionet e policisë dhe shërbimeve inteligjente se protesta e sotme e opozitës mund të shoqërohet me akte dhune, kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi ka anuluar mbajtjen e seancës së sotme plenare. Në një dalje të posaçme për mediat dje pasdite, kryeparlamentari duke iu referuar situatës së ngarkuar politike dhe paralizimit të institucioneve të sigurisë bëri të ditur se për të shmangur incidentet dhe ndonjë sulm të mundshëm ndaj institucionit të Kuvendit, kishte marrë vendimin për moszhvillimin e seancës plenare të parashikuar të niste sot në orën 10:00. "Duke pasur parasysh apelin e partnerëve tanë strategjikë, duke pasur parasysh informacionet e organeve ligjzbatuese dhe të inteligjencës, duke ndjekur qëllimin më të lartë të ruajtjes së integritetit të Kuvendit të Shqipërisë, të deputetëve dhe të sallës së Kuvendit, Ftoj kolegët deputetë, anëtarë të të gjithë grupeve parlamentare, të mirëkuptojnë vendimin tim për të mos zhvilluar seancën plenare të ditës së enjte, datë 21 shkurt", bëri të ditur Ruçi. Ai theksoi se kjo ishte një nga mënyrat për të evituar çdo mundësi që elementë të veçantë të përfitojnë nga protesta e opozitës për të goditur apo sulmuar Kuvendin gjatë kohës që deputetët do të ishin në sallë. "Përgjegjësia ime si Kryetar i Kuvendit, si një institucion mbi palët, por edhe si qytetar i këtij vendi, nuk më lejon t'u japë mundësi keqbesë, të cilët mund të përfitojnë nga kultura dhe dinjiteti i qytetarëve e de-



Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi

putetëve protestues, për të sulmuar institucionet e shtetit dhe për të nxitur imazhin e Shqipërisë", theksoi më tej Ruçi. Ai, gjithashtu, kërkoi që ky pushim i Kuvendit t'i shërbejë politikës që të bëhet më e matur dhe të reflektojë për të gjetur zgjidhjet e durim të interes të shqiptarëve. "Le të shërbejnë këto ditë për të na ndihmuar të reflektojmë dhe të bëhemi më të matur, më bashkëpunues, duke i vendosur platformat, ambici-

et dhe objektivat tona politike dhe elektorale në shërbim të të gjithë shqiptarëve", deklaroi kryetari i Kuvendit. Më tej duke komentuar zhvillimet e ditëve të fundit dhe në mënyrë të veçantë vendimin e opozitës për të dorëzuar mandatet e deputetëve, Ruçi theksoi se nuk e kishte menduar kurrë një vendim të tillë të cilin ai nuk nguroi ta konsideroi si vetëvrasës për opozitën. "Si kryetari i Kuvendit e jo si deputet apo si pjesë



MANDATET

"Si kryetar i Kuvendit e jo si deputet apo si pjesë e lidershipit politik të shumicës qeverisëse, jam seriozisht i shqetësuar për këtë situatë. Nuk do ta doja kurrë realizimin e skenarit të paralizuar nga vetë opozita, për të ashtuqajturën djegie mandatesh, sepse një opozitë që vetëvritet politikisht i bën vendit një dëm të madh"

e lidershipit politik të shumicës qeverisëse, jam seriozisht i shqetësuar për këtë situatë. Nuk do ta doja kurrë realizimin e skenarit të paralizuar nga vetë opozita, për të ashtuqajturën djegie mandatesh, sepse një opozitë që vetëvritet politikisht i bën vendit një dëm të madh. Një skenar i tillë, i padëgjuar, në dijeninë time, në asnjë rast të historisë së parlamentarizmit, është një lloj kamikazllëku

politik që hedh në erë të zotët e punës, por dëmtim padyshim rëndë të tërë mjedisin tonë, si edhe raportet e të tjerëve me këtë mjedis", - tha Ruçi. Gjithsesi ai u shpreh se mazhorancës nuk mund t'i vendosen ultimatumet dhe se është përgjegjësia e saj që të mbrojë vendin nga çdo lloj goditje që mund t'i bëhet imazhit të Shqipërisë. "Nuk është ky momenti dhe as është detyra ime si Kryetar i Kuvendit, të komentoj mbi këtë skenar nga këndvështrimi i shumicës qeverisëse, por mund të them se ultimatumet nuk janë demokratike, pushteti nuk merr në tavolinë dhe populli sovran nuk është një turmë sado e madhe qytetarësh që vijnë në një protestë, por tërësia e qytetarëve që na gjykojnë me votë", - deklaroi më tej Ruçi. Kryetari i Kuvendit shtoi se aktet u dhunës dhe situata e krijuar politike po dëmtim se pari, interesat e vendit dhe në mënyrë të veçantë ka vendosur në pikëpyetje marrjen e statusit të vendit kandidat në muajin qershor.

KUVENDI RRETHOHET ME TELA ME GJEMBA, 1600 POLICË PËR PROTESTËN

Për të parandaluar aktet e dhunës Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës kanë marrë masa për të ndaluar depërtimin e protestuesve në ambientet e Kuvendit. Për këtë në gjithë perimetrin rrethues të Kuvendit është vendosur një gardh me tela me gjemba. Ndërkohë që Policia dhe Garda janë vendosur në gatishmëri dhe kanë bërë sigurimin e Kuvendit me forca të përforuara shërbimi. Mësohet se për protestën e nesërme do angazhohen 1600 efektivi policie. Gjithashtu, mësohet se kryeministri Edi Rama nuk do të jetë nesër në Tiranë pasi do marrë pjesë në një aktivitet në Gjirokastër në kuadër të turit "Bashkia që duam".



Deputetët e opozitës dhe emrat pasues në listë firmosin dorëheqjet nga mandatet

Opozita djeg mandatet, Basha: Vendim i vështirë, skemi rrugë tjetër

Dy deputetët që refuzuan të firmosin

Valentina Madani

Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike votoi dje unanimisht për djegjen e mandateve. Pas votës unanime që mori më herët në grup dhe kryesi, Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike zyrtarizoi mbërmë vendimin për djegjen e mandateve të deputetëve. Vendimi i Këshillit erdhi në një atmosferë të ndezur para selisë së PD, ku mbështetës të shumtë ishin mbledhur dhe me thirrjet e tyre kërkonin djegjen e mandateve. Vendimin e komunikoi kreu i opozitës, Lulzim Basha, para dhjetëra simpazizantëve që kishin mbushur oborrin e selisë, i cili tha se ky ishte një vendim i vështirë, i paprecedentë, por e vetmja rrugë. Pas vendimit, secili deputet firmosur deklarantë e lënies së mandateve. "Kam nderin dhe privilegjin t'ju bëj të ditur vendimin unanimit të Këshillit Kombëtar të PDSH, për djegjen e mandateve parlamentare, me efekt të menjëhershëm", deklaroi z.Basha. Një vendim i vështirë e i paprecedentë sipas Bashës, nga ku nuk ka më kthim në betejën e nisur me qytetarët për të ardhmen europiane të vendit. "Ne e hedhim këtë hap, pasi kemi shteruar çdo mundësi për t'u kthyer legjitimitetin institucioneve të mbetura. Pas urdhrit të sovranit, i cili ushtoi në protestën më të madhe, në atë të së shtunës, ne nuk kemi asnjë rrugë tjetër. Zgjedhim me përgjegjësi të plotë t'i bindemi sovranit", deklaroi kreu i PD-së.



Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike

VIZITA

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, një ditë pas protestës para Kuvendit, do të zhvillojë një vizitë njëditore në Vjenë për të takuar zyrtarë të lartë në selinë e OSBE-së.

SALI BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha zgjodhi të reagoonte me një foto pas vendimit të Gramoz Ruçit për të shtyrë seancën plenare. Berisha shprehet shkurt "për së dyti", duke nënkuptuar ikjen e Ruçit në vitin 1996 për në Greqi. Berisha ka deklaruar disa herë që Ruçi iku i veshur me robra grash.

VENDIMI

"Ne e hedhim këtë hap, pasi kemi shteruar çdo mundësi për t'i kthyer legjitimitetin institucioneve të mbetura. Pas urdhrit të sovranit, i cili ushtoi në protestën më të madhe, në atë të së shtunës, ne nuk kemi asnjë rrugë tjetër. Zgjedhim me përgjegjësi të plotë t'i bindemi sovranit", deklaroi kreu i PD-së.



Letra, djegia e mandateve, opozita gjen mbështetje në SHBA

Partia Demokratike, aleatët e saj si dhe Lëvizja Socialiste për Integrim tri ditë më parë njoftuan për djegjen e mandateve të deputetëve. Ky vendim erdhi menjëherë pas protestës së të shtunës, e cila nuk kaloi pa kritika edhe nga ndërkombëtarët, pasi sipas tyre, qytetarët përdorën dhunë ndaj institucionit të kryeministrit. Por kjo nisim e opozitës së bashkuar nuk kaloi vetëm me kritika. Gjatë ditës së djeshme, një zë mbështetës ndaj tyre vjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Bëhet fjalë për Federatën Pan-shqiptare "Vatra" në Miçigan, e cila përmes një deklarate që mban datën e djeshme shpreh mbështetjen për opozitën e bashkuar për djegjen e mandateve dhe krijimin e një qeverie tranzitore, ashtu siç synojnë të gjithë aktorët opozitarë në vend. Duke listuar një sërë problemesh që shqetësojnë jetën e shqiptarëve, kjo federatë e quan të drejtë lëvizjen e opozitës.

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e PARE - për shfjerrjen e pasurisë së palajshme për të cilën ka vlerë hipotekë SHTETI BANK, me këto të dhëna: Pasuria "ARE" nr. 1705, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani diti.08.03.1969, zj.Merita Myzafër Kapllani diti.24.06.1970 Në vlerën 11.600.000 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind mijë) Lekë. Pasuria Apartament me sip.120m² nr.pas.41/150-1-1 z.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh R13 Durrës Në pronësi të z.Adrian Sefer Kapllani diti.08.03.1969. Në vlerën 5.381.856 (pesë milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 07.03.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbarturisë gjyqësor me adresë: Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

Protesta e opozitës, sot para Kuvendit

Opozita e bashkuar: Nëse ka një skenar dhune, ai gjendet në zyrën e Ramës

Opozita e bashkuar dënoi djegjen e Policisë së Shtetit, e cila më herët u shpreh se ka të dhëna se protestuesit do të hyjnë me forcë në sallën e parlamentit. Në një deklaratë për mediat, opozita thotë se nëse ka një skenar dhune apo sulmi ndaj institucioneve, ky skenar gjendet në zyrën e kryeministrit Rama. "Opozita e bashkuar dënon me forcë deklaratën e Policisë Politike dhe të ministrit të fundit të Brendshëm të diktaturës komuniste për nxitjen e dhunës nga opozita në protestën e së enjtes para Kuvendit të Shqipërisë. Nëse ka një skenar dhune apo sulmi ndaj institucioneve, ky



skenar gjendet në zyrën e Edi Ramës. Të tilla thirrje nga policia politike e Edi Ramës janë të dala boje. Protesta e 16 shkurtit provoi se mes protestuesve nuk ka kriminelë", thuhet në deklaratë. Më tej, duke komentuar vendimin për anulimin e seancës plenare

re të së enjtes, opozita shprehet se kjo nuk do të mund të ndryshojë axhendën e popullit. "Opozita e bashkuar njofton bandën në krye të qeverisë, Kuvendit dhe të policisë së koha e kërcënimit të shqiptarëve ka iku! Edi Rama mund të ndryshojë axhendën e parlamentit '339', mund të arrijë vetë nga Tirana, por është i pafuqishëm të ndryshojë axhendën e popullit. Sovrani do të ushtrojë nesër të drejtat e tij, në orën 10.00 para parlamentit, i cili nuk duhet të mbetet peng i krim-it dhe korrupsionit, por t'u kthehet sa më shpejt Shqipërisë dhe shqiptarëve", thuhet në deklaratën e opozitës së bashkuar.

kratët dhe socialistët e tradhtar, të mos mungojnë sot në orën 10:00 në protestën e thirrur para sallës së Kuvendit. "Vendimi i marrë sot është vetëm fillimi i një beteje. E di se këtë betejë të madhe ne të gjithë bashkuo do ta fitojmë për Shqipërinë, demokracinë për Evropën, SHBA. Do ta fitojmë për të sotmen e për të ardhmen. Ju ftoj në protestën e nesërme në orën 10:00 para Kuvendit të Shqipërisë, i cili një orë e më parë do t'u kthehet shqiptarëve. Zoti e bekoftë Shqipërinë, zoti i bekoftë sh-

qiparë!", u shpreh z.Basha. Pas vendimit, secili deputet firmosi këtë deklaratë për lënien e mandateve, ndërkohë firmosën dorëheqjet edhe kandidatët pasues të listës së PD-së. Pas deputetëve të PD-së, edhe ata të Lëvizjes Socialiste për Integrim firmosën dorëheqjet si deputetë. Ishte vetë kryetarja e kësaj force, Monika Kryemadhi, ajo që hodhi firmën e parë për heqjen e mandatit, duke u ndjekur më pas edhe nga deputetët e tjerë të kësaj force politike. I vetmi që refuzoi nga grupi i

deputetëve të LSI-së ishte Lefter Koka. Ai u distancua më herët nga ky vendim duke theksuar se është zgjedhur nga vullneti i popullit. Deklaratat personale do të depozitohen në një dosje dhe do të dorëzohen në Kuvend dhe në KQZ. Dorëzimi ishte planifikuar për sot por shtyhet për shkak të mungesës së disa deputetëve të opozitës si Rudina Hajdari, Fatmir Mediu etj.. Mësohet që deputeti i PD-së Myslim Murizi ka refuzuar të firmosë dokumentin për lënien e mandatit.

VENDIMI I OPOZITËS FIRMOSJA


Zbardhet dokumenti, si do dorëhiqen deputetët dhe kandidatët e PD-LSI nga mandatet

Valentina Madani

Të gjithë deputetët e opozitës në Parlamentin e Shqipërisë firmosën dje dorëheqjen vullnetare nga mandatet e tyre. Pas vendimit të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike për dëgjimin e mandateve, të gjithë deputetët e kësaj partie firmosën një dokument përmes të cilit njoftojnë lënie e mandatit. Ky dokument u firmos nga deputetët me mandat, por edhe nga kandidatët që janë në listat e Partisë Demokratike në 12 qarqet e vendit. Të njëjtën gjë bëri edhe LSI, me përjashtim të deputetit Lefter Koka, i cili refuzoi ta lërë mandatit. Dokumenti përmban të njëjtin tekst si për PD-në, ashtu edhe për LSI-në, përveçse logove përkatëse të partive respektive. Në dokument renditen arsyet e këtij vendimi, nëpërmjet të cilit deputetët demokratë i paraqesin Kuvendit dorëheqjen nga posti i tyre. Në tekstin e letrës së dorëheqjes nga mandati theksohen pesë arsyt kryesore të dëgjimit të mandatit. Të asgjësimit të demokracisë funksionale dhe shtetit të së drejtës; të kapjes së kësaj qeverie në flagrancë duke vjedhur votat e qytetarëve shqiptarë, siç dëshmojnë edhe dosjet gjyqësore të publikuara nga mediat ndërkombëtare. Të kapjes së kësaj qeverie në afëra flagrante korruptive kriminale, të eliminimit të parlamentit si një forum i demokracisë; të paralizës së shtetit, shtypjes sistematike, dhunimit të drejtave themelore të të njeriut dhe lirive të shqiptarëve duke përfshirë të drejtën e jetës, shëndetit dhe pronës. Letra thekson se vendi është në emergjencë kombëtare për shkak të asgjësimit të demokracisë. "Duke mbështetur plotësisht vendimin e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe zgjidhjen politike të ofruar nga opozita e bashkuar të një qeverie transitore, të gatshme për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm, që do të garantojnë zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe zhblokimin e procesit të integritetit evropian të Shqipërisë, si dhe hapjen e negociatave me Bashkimin Europian, përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të parakohshme parlamentare", thekson letra e PD-së. Me propozim të kryetarit të PD-së Lulzim Basha, grupi parlamentar Kryesia e PD-së dhe Këshilli Kombëtar i tha 'po' dëgjimit të mandat-


Djegia e mandateve, zbardhen arsyet e dorëheqjes së deputetëve

Zgjidhja politike e ofruar nga opozita e bashkuar



ARSYET

Në tekstin e letrës së dorëheqjes nga mandati theksohen pesë arsyt kryesore të dëgjimit të mandatit. Të asgjësimit të demokracisë funksionale dhe shtetit të së drejtës. Të kapjes së kësaj qeverie në flagrancë, duke vjedhur votat e qytetarëve shqiptarë, siç dëshmojnë edhe dosjet gjyqësore të publikuara nga mediat ndërkombëtare. Të kapjes së kësaj qeverie në afëra flagrante korruptive kriminale, të eliminimit të parlamentit si një forum i demokracisë, të paralizës së shtetit".



Gjatë një seance parlamentare

Koka nuk firmos dokumentin, Manjani: Tub oksigjeni për sundimtarët

Pas deputetëve të PD-së, edhe ata të LSI-së firmosën deklaratën për dorëheqjen nga mandatit. Këtë deklaratë nuk e firmosi vetëm deputeti Lefter Koka. Duke theksuar se është zgjedhur nga vullneti i popullit, Koka u shpreh se nisim është e ish-kryetarit të PD-së, Sali Berisha. Koka shprehet qartë edhe kundër protestave të opozitës së bashkuar ndaj qeverisë, duke theksuar se mandatit i tij nuk mund të përdoret asesi për t'u vënë flakën institucioneve shtetërore apo parlamentit shqiptar. Vendimin e deputetit të Durrësit, Lefter Koka, për të mos e dëgjur mandatit e deputetit, duke dalë kështu kundër ven-



dimit politik të LSI-së e ka komentuar edhe Ylli Manjani. Ai e quan Lefter Kokën mik të mirë dhe një nga kontribuuesit e LSI-së qysh prej themelimit të saj, por nuk pajtohet me zgjedhjen e tij. Manjani i jep edhe një këshillë, duke i thënë se asnjëherë nuk është vonë për t'u ngritur mbi interesat personale. "Lefter Koka është një shok i mirë dhe kontribuues

politik që nga themelimi në LSI. Singjerisht, ende nuk e mendoj që LSI-ja mund ta humbasë këtë kontribuues. Qëndrimi i tij personal, sigurisht është i papranueshëm dhe nuk mund të zhbëjë dot vendimin politik të opozitës, përfshi këtu edhe LSI. Ndoshta mungesa e komunikimit normal të LSI-së me Lefterin mund të ketë vështirësuar disi qytetueshmërinë e qëllimit të mirë të vendimit politik, për të mos qenë as fasadë dhe as tubi i oksigjenit të sundimtarëve të sotëm arrotë. Asnjëherë nuk është vonë për t'u ngritur mbi interesat personale. Lefteri ka ditur të dalë mbi interesat personale. Shpresoj të vijojë ta bëjë...", tha z.Manjani.

eve parlamentare dhe tashmë vjen edhe vendimi përfundimtar nga Këshilli Kombëtar, duke krijuar një rast të paprecedent. Të njëjtën gjë bëri edhe LSI-ja, duke marrë miratimin e forumeve

të partisë. Prej së dielës kur Basha bëri propozimin e tij, ka zhvilluar një sërë takimesh si brenda forumeve të PD-së, ashtu edhe me aleatë. Po ashtu, edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi.

Ndërkohë, dy ditët e fundit kanë qenë intensive në takimet me diplomatët e huaj. Përfaqësuesit e BE dhe SHBA janë shprehur kundër vendimit të opozitës për dëgjimin e mandateve.

Anulimi i seancës, Mustafaj: Parlamenti të bëjë detyrën, ose të shkrihet

Ish-ministri dhe analisti Besnik Mustafaj komentoi ndje situatën politike në vend, duke nisur nga dëgjia e mandateve të opozitës dhe reagimet nga ana e mazhorancës. Lidhur me anulimin e seancës së sotme parlamentare nga kryeparlamentari Gramoz Ruçi, Mustafaj tha në "News 24" se shpreson të jetë e fundit. Sipas tij parlamenti ose duhet të vazhdojë detyrën kushtetuese, ose duhet të shkrihet dhe të ketë zgjedhje. "Vendimi i zotit Ruçi është sigurisht një mënyrë për të shmangur tensionet që mund të dalin jashtë kontrollit. Nuk më cudit dhe as më indinjon kjo që ka bërë zoti Ruçi. Parlamenti i Shqipërisë duhet të vazhdojë detyrën e tij kushtetuese ose të shkrihet dhe të shkojë në zgjedhje. Realisht shpresoj që të jetë e fundit", tha Mustafaj. Për sa u përket mandateve, Mustafaj deklaroi se ky është një radikalizim nga ana e opozitës dhe se nëse dështon do ketë një dëm të madh moral dhe psikologjik. "Unë s'do marr përsipër të gjykoj nëse kishte të tjera alternativa apo nëse kjo është me mira që mund të bënte PD. Jemi para faktit të kryer: PD konsumon aktin më ekstrem politik. Nëse dështon do jetë një dëm shumë i madh për PD-në dhe demokracinë në Shqipëri. Opozita do pësojë një dëm të madh moral dhe psikologjik. Ka disa arsye pse themi nëse dështon. Kur bën një analizë, duhet menduar dhe mundësia e keqe jo vetëm e mira. Kjo opozitë, këta deputetë, opinioni publik shqiptar kanë përballë Edi Ramën si person, që është dhe kryetar i mazhorancës dhe në jetën politike nuk ka pasur politikanë që kanë qenë kaq refuzues për të dëgjuar opinionin", u shpreh Mustafaj.

SUGJERIMET

"Nuk dimë asnjë rast që mazhoranca ka marrë me seriozitet sugjerimet e opozitës. Mundësia që kjo masë radikalizimi e opozitës të dështojë në objektivat e veta vjen edhe për shkak të sjelljes pa kuptim politik që ka kryetar i mazhorancës", deklaroi z.Mustafaj.

Njoftim për shitje me anand te III

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur në datë 11.02.2019 ankandin e tretë të pasurisë të palës debitore Shoqëria "G.P.R.A" sh.p.k e përbërë nga:

Pasuria Nr 31/33, në Z.K.Nr. 2255, volumn nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m², në Koxhas, Durrës Ankandin III fillim me çmim fillëstar në masën 103.071, 09 Euro.

Pasuria Nr 31/4, në Z.K.Nr. 2255, volumn nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12.900 m², në Koxhas, Durrës, Ankandin I fillim me çmim fillëstar në masën 189.066,5 Euro.

Pasuria Nr 31/3, 2, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, me sipërfaqe totale 4.300 m², në Koxhas, Durrës Ankandin I fillim me çmim fillëstar në masën 63.022,1 Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë 13.03.2019 ora 15:00 në selinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakti tel. 0672082543, ltr. derwishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice.al.com

Njoftim për shitje me anand te III

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur në datë 11.02.2019 ankandin e tretë të pasurisë të palës debitore SH "Stati Construction" sh.p.k dhe të palës dorezuese, e përbërë nga:

"Ate" me numër pasurie 172223 në Zonen Kadastrale Nr. 1522, volumni 3, faqe 249, Ankandin fillim me çmim fillëstar në masën 2.016.000 leke

"Apartament", me numër pasurie 116/61-1-19 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumni 22, faqe 42, Ankandin fillim me çmim fillëstar në masën 957.600 leke

"Apartament", me numër pasurie 116/61-1-20 Zonen Kadastrale Nr. 2291, volumni 23, faqe 43, Ankandin fillim me çmim fillëstar në masën 1.713.600 leke

Ankandi do të zhvillohet në datë 13.03.2019 ora 15:00 në selinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakti tel. 0672082543, ltr. derwishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice.al.com

NJOFTIM ANKANDI

Përmbaruesi Gjyqësor Lekë Dodaj shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajshme të palës debitore, si më poshtë:

1. Garazh nr.68/55-G9, zona kadastrale 3252, volumni 25, faqe 39, ndodhur në Shtëpitë Tiranë në pronësi të z.Besnik Abaz Hoshafi.

Cmimi me të cilin do të fillojë Ankandi i Parë është 5.681 (pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) Euro.

Ankandi zhvillohet në datën 05.03.2019, Ora 16.00 në zyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Lekë Dodaj në adresën Rruga "Astrit Balluku", Ndërtesa 2, Hyrja 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për kontakt: 067.39.00.666, dhe në adresë emaili leke_dodaj@hotmail.com.




Presidenti: Protesta të jetë paqësore, opozita të bëjë një hap prapa, dy mazhoranca

Meta, thirrje për reflektim: Djegia e mandateve, vendim ekstrem

"Nuk i shërben demokracisë dhe integritimit"

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta e quan zhvillim të padëshiruar përshkallëzimin e protestave apo të politikave ndarëse dhe bën thirrje për reflektim dhe qasje tjetër. Sipas tij, ky vendim ekstrem i opozitës vjen në një kohë që vendi pret një përgjigje për hapjen e negociatave. Në një intervistë dhënë për "Deutsche Welle", Meta vlerëson se çdo veprim ekstrem nuk i shërben demokracisë. Kreu i shtetit ndodhej në Berlin, ku pati dhe një takim me Presidentin e Gjermanisë, zotin Steinmeier. "Vlerësoj se çdo veprim ekstrem nuk i shërben demokracisë, nuk i shërben forcimit të institucioneve dhe nuk i shërben njëkohësisht as integritimit evropian të vendit, që është dëshira e çdo qytetari shqiptar", theksoi kreu i shtetit.



Presidenti Ilir Meta

DEKLARATA

"Vlerësoj se çdo veprim ekstrem nuk i shërben demokracisë, nuk i shërben forcimit të institucioneve dhe nuk i shërben njëkohësisht as integritimit evropian të vendit, që është dëshira e çdo qytetari shqiptar", theksoi kreu i shtetit.

"Ata që nxisin dhunën do mbajnë përgjegjësi"

Djegia e mandateve, OSBE: Keqardhje që s'dëgjat miqtë ndërkombëtarë

Pas votimit unanimit të Këshillit Kombëtar të PD-së për djegjen e mandateve, OSBE e cilësoi këtë veprim si heqje dorë nga përgjegjësia, ndërsa bëjnë thirrje që të mos ketë skena dhune, duke theksuar se, "ata që mundësojnë dhe nxisin dhunën do të mbajnë përgjegjësi". "Vendimi i deputetëve të opozitës për t'u dorëhequr nga Kuvendi minon procesin demokratik ligjvënës dhe përbën një heqje dorë nga përgjegjësia e tyre për të përfaqësuar qytetarët që i kanë votuar. Reformat thelbësore dhe gjerësisht të mbështetura po vonohen. Prezenca e OSBE-së këshillon fuqishëm që të mos ndërmerret asnjë përpjekje për të tronditur themelet e demokracisë përmes dhunës, që të mos ndërshohet procesi demokratik përmes presionit jodemokratik. Ata që mundësojnë dhe nxisin dhunën do të mbajnë përgjegjësi. Na vjen keq që paralajmërimet e kaq shumë miqve dhe partnerëve afatgjatë të Shqipërisë nuk u dëgjuan", shkruhet në deklaratë.



MAKOTO ITO

"Unë shpresoj që ata ta kalojnë këtë fazë dhe të vazhdojnë të kenë dialog me njëri-tjetrin. Përmes dialogut mund të arrihet gjithçka. Dialogu është shumë i rëndësishëm", deklaroi ambasadori i Japonisë.

Ndërkohë, kjo nuk është thirrja e parë që vjen nga ndërkombëtarët për mosdjegjen e SHBA-ve, ajo që theksoi se një demokraci e shëndetshme kërkon një opozitë që funksionon në mënyrë konstruktive brenda institucioneve kushtetuese.

Protesta, ambasadori italian: Të jetë paqësore, dënojmë dhunën

Ambasadori i Italisë në Tiranë, Alberto Cuttillo, deklaroi se liria e shprehjes nuk mund të justifikojë deklaratat që nxisin dhunën. Ai thotë se shpreson që protesta e së enjtes të jetë paqësore dhe se do shprehje dhe dhunshme do të dënohet nga pala italiane. "Protestat janë një mjet ligjor i shprehjes së shoqërisë demokratike, por liria e shprehjes nuk mund të justifikojë deklaratat që nxisin dhunën dhe akoma më pak akte të dhunshme. Shpresoj që protestat e nesërme (sotme) të jenë paqësore dhe të ruhet respekti për institucionet e shtetit. Çdo shprehje e dhunshme e pakënaqësisë do të dënohet me vendosmëri nga pala italiane", shprehet ambasadori Cuttillo.

Ambasadorët e BE, takime në PD dhe LSI

Soreca, porosi Bashës: Presim që të mos jetë e dhunshme

Vendimi i opozitës për lënien e mandateve vuri dje në lëvizje ambasadorët e akredituar në Tiranë. Pak orë para protestës, përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, Luigi Soreca, zhvilloi një takim kokë më kokë në selinë blu me kryetarin e PD-së, Lulzim Basha, ku kërkoi dialog politik. Përsa i përket protestës së të enjtes, ai ka bërë thirrje për t'u larguar akteve të dhunës. Në një prononcim të shkurtër pas takimit, Soreca tha se i bëri të qartë zotit Basha qëndrimin e Bashkimit Evropian. "Fola me secilin dhe është mjaft e rëndësishme për të ndarë këto pozicione. BE ka qenë mjaft e qartë, i kemi shpjeguar liderit të PD-së edhe pozicionin tonë. Është e rëndësishme për të folur dhe diskutuar. Nesër (sot) është një ditë e rëndësishme, presim që të mos jetë e dhunshme, procesi demokratik duhet të prevalojë", deklaroi z.Soreca. Më herët ishte ambasadorja e Gjermanisë në Tiranë, Susanne Schütz, që takoi Lulzim Bashën, me të cilin diskutoi për djegjen e mandateve si dhe për protestën e sotme. Pasi la selinë blu, Schutz ka takuar edhe aleatin e PD, kryetaren e LSI, Monika Kryemadhi. Të martën e 19 shkurtit, Basha priti në një takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri, Duncan Norman. Para dy ditësh edhe ambasada e SHBA-ve në Tiranë u bëri thirrje deputetëve të opozitës që të mos pranojnë djegjen e mandateve, duke theksuar se një vendim i tillë minon parimet bazë të demokracisë.



strumentalizuar këtë pakënaqësi dhe zemërim nga çdo palë, por për ta lexuar dhe për të reflektuar gjithkush me përgjegjësi se si kjo të kthehet në një energji pozitive për zhvillimin e vendit", deklaroi z.Meta.

Presidenti foli edhe për marrëveshjen e mundshme mes Kosovës dhe Serbisë, që sipas tij duhet arrihet përmes bashkëpunimit të SHBA-ve dhe Gjermanisë me shumë se një bashkëpunim SHBA-BE.

Ambasada e SHBA: Potenciale për dhunë në protestë

Ambasada amerikane në Tiranë njoftoi dje qytetarët e saj që të jenë të kujdesshëm dhe të qëndrojnë larg turmave gjatë protestës së sotme të opozitës. Sipas deklaratës, pikat ku do të ketë grumbullime të njerëzve janë zona e Zogut të Zi, zona e Qytetit Studentit, Stadiumi "Selman Stërmasi" dhe Rruga "George W. Bush", para Parlamentit Shqiptar, ku edhe është parashikuar zhvillimi i protestës. "Grupi ka për qëllim të demonstrojë kundër qeverisë shqiptare. Kohëzgjatja e demonstratës është e panjohur dhe është e mundur që demonstruesit të marshojnë në vende të reja gjatë protestës së tyre. Potenciali për dhunë ekziston. Një demonstrim i ngjashëm më 16 shkurt 2019 u bë i dhunshëm dhe rezultoi me plagosje të shumta për demonstruesit dhe policinë", thuhet në deklaratë. Personeli i Ambasadës së SHBA-ve u kërkoi qytetarëve amerikanë që të shmangin protestën. Gjithashtu, thuhet se më 21 shkurt 2019, nga ora 8:30 deri në orën 10:45, hyrja dhe dalja nga Ambasada e SHBA-ve do të kufizohet, ndërsa shërbimet konsullore ruti-nore të planifikuara për mëngjesin janë anuluar. "Operacionet konsullore të pasdites janë planifikuar të rifillojnë si normale", thuhet në deklaratë.

Vendimi për t'i hapur rrugë kalimit të ushtarakëve në radhët e Policisë së Shtetit

Qeveria barazon gradat e ushtrisë me ato të policisë, ja si përshtaten

Miratohet kalimi i 100 ushtarakëve të parë

Ushtarakëve u hapet rruga që të kalojnë në radhët e ushtrisë duke ruajtur të njëjtën gradë dhe duke përfutur të njëjtat përfitime financiare si policët. Qeveria ka miratuar dje vendimin për ekuivalentimin e gradave të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura me ato të Policisë së Shtetit, çka krijon tashmë mundësinë që çdo ushtarak që mban një gradë të caktuar në radhët e ushtrisë të mbajë një gradë ekuivalente me të edhe në radhët e policisë. Bashkë me këtë vendim është miratuar edhe lista e gradave të ekuivalentuara ku grada më e ulët në ushtri, pra ajo e Nëntogerit barozohet me gradën e Nënkomisarit, ajo e Togërit me atë të Komisarit dhe për të mbërritur te grada më e lartë në ushtri ajo e Gjenerallejtënantit me atë të Drejtuesit Madhor në Polici. Burime nga Ministria e Mbrojtjes qartësojnë se bëhet fjalë vetëm për ekuivalentim gradash dhe jo unifikim të tyre, çka do të thotë që ky vendim nuk do të ketë efekte financiare te pagat e ushtarakëve me grada. Sipas të njëjtave burime nga Ministria e Mbrojtjes me ndryshimet në ligjin e Policisë së Shtetit është krijuar mundësia e kalim-



Foto ilustruese

it të ushtarakëve në strukturat e Policisë së Shtetit. Ky vendim krijon mundësinë që ish-ushtaraku i liruuar kur të shkojë në Policinë e Shtetit të mos humbasë karrierën dhe vitet e shërbimit, por të marrë një gradë policore në përputhje me gradën e fundit që ka mbajtur në Forcat e Armatosura. Gjithashtu, duke iu referuar ndryshimit ligjor të miratuar në fund të

vitit të shkuar, mësohet se nuk kalon asnjë ushtarak automatikisht nga ushtria në polici, pasi kjo do të bëhet sipas kuotave dhe strukturave që dakordësohen me marrëveshje mes ministrave dhe vetëm pasi janë larguar nga ushtria, pra pasi kanë dalë në lirim. Ndërkohë që bashkë me këtë vendim, qeveria dje ka miratuar edhe kalimin e kontingjentit të


EKUIVALENTIMI I GRADAVE MES POLICISË DHE USHTRISË	
■ Inspektor	= Reshter
■ Nënkomisar	= Nëntoger
■ Komisar	= Togër
■ Kryekomisar	= Kapiten
■ Drejtues	= Major
■ Drejtues i parë	= Nënkolonel
■ Drejtues i lartë	= Kolonel
■ Drejtues madhor	= Gjeneral

parë të ushtarakëve në radhët e policisë. Bëhet fjalë për 100 ushtarakë me grada të cilët kanë dalë në lirim dhe që tashmë do të kalojnë në radhët e Policisë së Shtetit. Sipas vendimit të qeverisë radhët e Policisë së Shtetit shtohen me 100 persona dhe numri i përgjithshëm i policëve shkon në 11 058. Ndërkohë që sipas një vendimi tjetër të qeverisë të marrë

po gjatë ditës së djeshme bëhet dhe ndryshimi në organikën e Ministrisë së Mbrojtjes, të cilët i zbriten 100 persona dhe ata i shtohen organikës së Ministrisë së Brendshme. Bashkë me kalimin e këtij kontingjenti nga Ministria e Mbrojtjes te ajo e Brendshme kalon edhe fondi i vaktuar për pagat e këtyre ushtarakëve që tashmë do shërbejnë si policë.

Hapen 495 vende të lira pune në administratë, profesionet që kërkojnë

Qeveria shpall 495 vende të lira pune në administratën shtetërore. Bëhet fjalë për vende pune me status të nëpunësit civil të cilat janë shpallur bosh dhe që duhet të plotësohen në vitin 2019. Vendimi është miratuar në mbledhjen e djeshme të qeverisë dhe këto vende janë ndarë sipas kategorive: 8 për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, 62 për kategorinë e mesme drejtuese, 109 për kategorinë e ulët drejtuese dhe 235 për kategorinë ekzekutive. Ndërkohë që për t'u punësuar në këto vende pune kërkojnë persona që kanë mbaruar degë të ndryshme të shkollës së lartë, duke filluar nga shkenca juridike, shkenca ekonomike, shkenca shoqërore, shkenca sociale, histori-filologji, shkenca mjekësore, veterinar, agronomi, biologji, kimi, shkenca mjedisore, shkenca inxhinierike, arkitekturë, arkeologji dhe restaurime, artet e bukura, gjeodezi, shkenca edukimi, mësuesi dhe arsimi i lartë ushtarak/policor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË

Rr: 'Ibrahim Rugova', Tiranë, Shqipëri. www.gjykatelarte.gov.al Telefon/Fax: +355 25/306

N J O F T I M

Sipas nenit 125 të Kushtetutës (e ndryshuar), nga 9 (nëntë) anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Në zbatim të këtij detyrimi kushtetues dhe bazuar në pikën 3 të nenit 9, të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar me ligjin nr. 99/2016), me shkresën nr. 60, datë 14.02.2019, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Kryetarin e Gjykatës së Lartë për krijimin e një vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese, si rezultat i largimit të gjyqtarit Gani Dizdari, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve.

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, ky vend vakant i krijuar në Gjykatën Kushtetuese, është emërtesë e Gjykatës së Lartë. Pra, zgjedhja e këtij anëtar do bëhet nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Për këtë arsye, në zbatim të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, shpall hapjen e procedurës së aplikimit të kandidatëve që dëshirojnë të konkurrojnë për këto vende vakante.

Afati i pranimit të kërkesave të kandidatëve, sipas nenit 7/ç të ligjit të sipërpërmendur, është 30 ditë nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Mbas kalimit të këtij afati, dokumentacioni i paraqitur nga kandidatët do t'i përcillet Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili është organi kompetent për vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të emërimit të kandidatëve. Mbi bazën e këtij vlerësimi, ky Këshill bën edhe renditjen e kandidatëve.

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese sipas neni 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar) janë si vijon:

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përbush këto kushte:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
- të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

- të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- vjetërsisë në profesion;
- përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
- kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
- treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
- ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerëshme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
- informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

Në përfundim të afatit të paraqitjes së kërkesave, Lista me emrat e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Kjo bëhet në zbatim të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me qëllim që institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë të mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI
XHEZAIR ZAGANJORI**

Bregasi: Është një PPP në mënyrë ekskluzive, i cakton çmimet sipas interesave

Tarifa "e fshehur" në Sharrë, reagojnë bizneset: Vendim korruptiv

Aleksi: Tarifa që paguajmë është 480 lekë të reja për 1 ton

Bizneset reagojnë kundër kontratës me Partneritet Publik Privat që operon në zonën e Sharrës. Pas publikimit nga "News 24" të afërës me tarifën shtesë, që ndërtesit duhet t'i paguajnë koncesionarit të Sharrës, kanë reaguar "Biznes Albania" dhe Shoqata e Ndërtuesve. Ata e cilësojnë këtë, një vendim me natyrë klientiste dhe korruptive. Kreu i shoqatës së "Biznes Albania", Luan Bregasi, thotë se është njohur me situatën që prej dy muajsh. "Biznes Albania" është njohur me këtë shqetësim para 2 muajsh nga Shoqata e Ndërtuesve. Është e vërtetë që një kompani që ka marrë licencën e një landfilli privat, ka marrë të drejtën ekskluzive me VKM që të gjitha gërmimet që bëhen në Tiranë për të gjitha kompanitë, edhe sektori publik, janë të detyruar që ta çojnë këtë produkt në këtë landfill me një pagesë që është rreth 480 lekë për ton", - shprehet Bregasi. Për "Biznes Albania", koncesionarit të inceneratorit të zonës së trajtimit të mbetjeve në Sharrë "Integrated Energy B. V", me anë të koncesionit i është dhënë mundësia për t'iu vendosur ndërtuesve tarifa sipas interesit të tij. "I është dhënë një PPP në mënyrë ekskluzive një kompanie private, që i cakton çmimet sipas interesave të saj. Tenderi i landfillit është bërë pa konkurencë, pra është bërë me PPP, e cila tashmë i kanë rritur kostot në mënyrë artificiale jo vetëm ndërtimit, por edhe kompanive të tjera që marrin PPP pa garë", - vijon Bregasi.



Kreu i shoqatës së "Biznes Albania", Luan Bregasi

derdhen diku tjetër, policia bashkiake e penalizon me gjobë, masa e së cilës është edhe më e madhe sesa kjo tarifë. "Njësia e qeverisjes vendore duhet ta publikon, por ndërtesit e paguan se kur të del ai i policisë bashkiake atje, i vendos gjobë çdo kamioni. Tarifa që paguajmë është 480 lekë të reja për 1 ton, ka që paguajnë edhe mbejtje të tjera 1200 lekë të reja 1 ton", - tha Aleksi. Si Shoqata e Biznesit, ashtu dhe Shoqata e ndërtesve theksojnë faktin se bëhet fjalë për dhera të pakontaminuar, thënë ndryshe, dhera që mund të përdoren për qëllime të tjera dhe jo të përfundojnë në landfill mbetjesh. Atyre nuk iu është dhënë asnjë arsye se përse janë të detyruar që dherat e mbetura nga

punimet t'i shkarkojnë me çdo kusht në landfillin e Sharrës. Biznesmenët dhe ndërtesit thonë se për këtë koncesion ekskluziv i janë drejtuar me një letër qeverisë. Gjithashtu, paralajmërojnë se këtë vendim klientelist dhe korruptiv do ta çojnë në Gjykatën Kushtetuese.

SHQETËSIMI

Shqetësimi i bizneseve dhe ndërtesve ka lindur për shkak të situatës së krijuar në landfillin e Sharrës, ku koncesionari i inceneratorit të zonës së trajtimit të mbetjeve "Integrated Energy B.V", ka caktuar një tarifë 480 lekë/ton, për çdo metër që shkarkon dhera, ndërkohë që merr nga bashkia 29 euro për çdo ton mbetje organike që prodhuar nga banorët e

kryeqytetit dhe zonave përreth. Situata monopol ka marrë miratimin e bashkisë së kryeqytetit, ndërkohë që vendimi i qeverisë për menaxhimin e mbetjeve ka dalë që në vitin 2015, kur mbetjet trajtoheshin nga Bashkia e Tiranës.

Ndërtimi paguan më shumë taksa

Subjektet e ndërtimit janë ato që paguajnë më shumë taksa dhe tarifa vendore ndaj bashkisë së kryeqytetit, ndërsa ambulantët paguajnë më pak. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bërë një kategorizim të pagesës mesatare që kryejnë bizneset në një vit, duke përjashtuar këtu tabelat reklamuese që janë individuale dhe taksën e ndërtesës, që ndryshon nga subjekti në subjekt. Kështu, një biznes i vogël në sektorin e ndërtimit paguan 24 mijë lekë në vit, më pas renditen bizneset që kryejnë aktivitetet në sektorin e shitjes me shumicë, që paguajnë 17 mijë lekë në vit dhe njësitë e prodhimit, 16.500 lekë në vit, duke u ndjekur nga njësitë e shërbimit dhe shoqatat. Detyrimi vjen në rritje progresive sipas kategorisë së subjekteve. Kështu, bizneset e mëdha në fushën e ndërtimit paguajnë 327 mijë lekë taksa vjetore, njësitë e prodhimit 179 mijë lekë dhe shitja me shumicë 101 mijë lekë. Ndërsa rëndësinë më të madhe fiskale e kanë subjektet VIP, ku ato në sektorin e ndërtimit paguajnë në një vit 487 mijë lekë, njësitë e prodhimit 397 mijë lekë dhe subjektet e shitjes me shumicë paguajnë 131 mijë lekë në vit. Ambulantët në të gjitha kategoritë paguajnë vetëm 3 mijë lekë në muaj.



Projektligji për nxitjen e punësimit

Ministrja Denaj: Rikonceptim i Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, prezantoi dje në Komisionin parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë projektligjin "Për nxitjen e punësimit". Ministrja theksoi se projektligji ka për qëllim rritjen e punësimit së forcave të punës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit dhe vetëpunësimit, si dhe formimit profesional. Ai përcakton objektivat dhe funksionet e sistemit publik të shërbimeve të punësimit, programeve aktive dhe pasive të tregut të punës, formimit profesional si dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e tyre. "Në këtë projektligj është parashikuar krijimi i institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësimin (sot Shërbimi Kombëtar i Punësimit), si një njësi, e cila do të mbledhë në një dhe do të rikonceptojë sipas praktikave më të mira modernizimin e zyrave të punës, sistemin e shërbimeve të punësimit, pro-



gramet e nxitjes së punësimit dhe ofertën e përmirësimit të aftësisë gjatë gjithë ciklit të jetës", u shpreh Denaj. Me anë të këtij projektligji rregullohen dispozitat në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, të cilat nuk kanë gjetur zbatimin e duhur në ligjin ekzistues. Ministrja informoi deputetët se projektligji parashikon krijimin e Fondit Social të Punësimit, në formën e një fondi financiar publik, që administrohet nga Bordi i Administrimit të Fondit. "Burimi i financimit të fondit do të jetë kontributi i punëdhënësve, të cilët nuk punësojnë 1 person me aftësi të kufizuara për çdo

49 punonjës të punësuar të tyre dhe në këtë rast janë të detyruar të derdhen një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 50% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person me aftësi të kufizuara që ai duhet të kishte punësuar. Të ardhurat e mbledhura do të përdoren për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësim dhe riaftësim profesional, orientim dhe këshillim për punësim, shërbime mbështetëse, si dhe përshtatjen e arsyeshme në vende pune të këtyre personave", shpjegoi ministrja Denaj.

REPUBLICA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME
SHËRBIIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT
URDHËR

Për Shpalljen e funksioneve të lira për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.

Në mbështetje të neneve 3 pika a, 21 dhe 76 e vijues dhe 86 të Ligjit Nr.70/2014 Për Shërbimin Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe bazuar në Urdhrin Nr. 579, datë 26.10.2018, " Mbi miratimin e Strukturës dhe Organikës të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme" si dhe neneve 107, 108 e vijues të Rregullores së Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, miratuar me Vendim Nr.829 , datë 03.12.2014 , të Këshillit të Ministrave.

URDHËROJ:

- Shpalljen e 6 (gjashtë) funksioneve të lira për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Funksionet e shpallura janë "Specialist" (pa gradë) me pagë III-b.
- Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë kriteret bazë të mëposhtme:
 - Arsimi i lartë, "Master i Shkencave" në Drejtësi; Ekonomik-Financë.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
 - Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punojë në grup.
 - Të jetë i gatshëm të caktohet me shërbim kudo, brenda territorit të vendit.
 - Të kenë përvojë pune jo më pak se 2 (dy) vjet dhe vlerësime të larta në punë, në administratë publike dhe jo publike me natyrë të ngjashme pune, sipas vendit të punës.
- Periudha e aplikimit fillon me datë 21.02.2019 dhe përfundon më datë 04.03.2019.
- Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (Personeli) të bëjë shpalljen e funksioneve të lira me informacione të mëtejshme në lidhje me kërkesat për kandidatët sipas pozicioneve të punës dhe aflistimin e tyre në Zyrën e Informacionit të SH.Ç.B.A-së.

Vajza e viktimës: Si i gjeta prindërit të mbuluar nga gjaku

Grabitja në Kamëz, bashkëshortja e tregtarit Agim Buci: U vra teksa mbronte djalin 7 vjeç

TIRANË - Rita Buci, e veja e tregtarit që u ekzekutua nga grabitësit në dyqanin e familjes në Kamëz, dëshmoi në Gjykatën e Tiranës në procesin ndaj dy të pandehurve për krimin, Vladimir Kurti e Ruzhdi Hoda. Mes lotësh, grua, e cila mbeti edhe vetë e plagosur në ngjarjen, rrëfeu se i shoqi u vra, pasi tentoi të mbronte djalin shtatëvjeçar nga grabitësit. "Në mbrëmje në dyqan erdhi djali i vogël 7 vjeç e me kërkoi ta ndihmoja për detyrat. Ishim gati duke mbyllur qepenat, kur Agimi më thirri në magazinë se po bënte sisteme. Mora disa portokalle të kalbura për t'i hedhur dhe sa dola në dyqan, përpara meje ishin dy persona të maskuar. Njëri kishte pistoletë në dorë, ndërsa tjetri mendoj se kishte



Bashkëshortja e viktimës, Rita Buci

thikë. Më zuri tmerrri nga djali dhe hodha gjëra në drejtim të tyre. Më qëlluan me pistoletë në këmbë. Agi

mi erdhi menjëherë dhe u përlësh, pasi njëri nga personat e maskuar kishte kapur djalin të supi. Ai e

qëlloi me armë", - është shprehur Rita Buci. E lidhur pas një paterice që prej mbrëmjes së 25 prillit të një viti më parë, që i tjetërsi rrjedhën e jetës, grua, tha se shpresonte shumë që i shoqi të mbijetonte, edhe pse vetë nuk mundi t'i jepte ndihmë. "Në dyqan hyri vajza. Mes ulërimash më pyeti çfarë ndodhi. I thashë 'na vranë hajdutët'. Thirri xhaxhain dhe ngritën Agimin e mua dhe na transportuan në spital. Agimi nuk ia doli dot". Sa për autorët e krimin, nëna e katër fëmijëve tha se nuk arriti t'i njihje, pasi ishin të maskuar. Pas saj



Tregtari i vrarë, Agim Buci

dëshmoi e bija, e cila tregoi momentet e tmerrit kur gjeti prindërit të mbuluar nga gjaku. Për akuzën e grabitjes me armë me pasojë vdekjen e tregtarit Agim Buci dhe plagosjen e së shokës Rita, akuzohen dy të rinjtë Vladimir Kurti e Ruzhdi Hoda. Procesi ndaj të pande-

hurve zhvillohet nën masa të rrepta sigurie, pasi ndiqet nga familjarët e të dyja palëve si personave të akuzuar ashtu dhe palës së dëmtuar, ndaj forcat e policisë qëndrojnë në gatishmëri për të shmangur ndonjë përplasje të mundshme mes tyre. **kl.la**

Deputeti i LSI-së, Petrit Vasili nuk paraqitet në organin e akuzës

Abuzimet me 5 tenderët në MD, merret në pyetje ish-ministri Ylli Manjani

"Në prokurori isha si dëshmitar. Praktikat i firmosa për shkak të detyrës, s'jam marrë me teknikalitete"

TIRANË

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani është marrë dy ditë më parë në pyetje në prokurorinë e Tiranës në lidhje në lidhje me skandalin e tenderëve të zhvilluar në këtë institucion gjatë viteve 2016-2017. Buri me për "Gazeta Shqiptare" bënte me dije se gjatë marrjes në pyetje për afro dy orë, Manjani ka thënë se ka firmosur praktikat për shkak të detyrës dhe se nuk është marrë me teknikalitete. Mësohet se prokuroria e Tiranës i ka dërguar një fletëthirrje edhe Petrit Vasilit për të dëshmuar ditën e djeshme në orën 14:00, por ish-ministri i Drejtësisë, aktualisht kreu i grupit parlamentar të LSI nuk është paraqitur. Ndërkaq, Ylli Manjani ka folur për "GSH" pas dëshmisë së dhënë në prokurori në lidhje me dosjen e abuzimit me tenderët në këtë institucion në kohën kur ai ishte ministër. Manjani deklaroi se vajtja në prokurori e tij ishte në cilësinë e dëshmitarit. Ai tha se ka folur kur mbante një detyrë publike dhe se tani nuk ka përgjegjësi të japë shpjegime publike. "Unë nuk mbaj tashmë asnjë detyrë publike e për pasojë nuk kam asnjë barrë të jap shpjegime publike për këtë gjë. Gjithçka kam pasur për



Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani

të ndarë me publikun e kam bërë kur mbaja detyrën publike. Sot jam qytetar i lirë dhe pa asnjë hezitim jap shpjegimet e mia në çdo institucion hetimor. Këtë gjë e bëj në diskrecion të plotë dhe në respekt të ligjit. Moshdhënia e shpjegimeve do ishte anomali jo e kundërta", - deklaroi Manjani. Gjithsesi, ai ka preferuar të mos flasë për dëshminë e tij dhënë para oficerit të policisë gjyqësore. "Vajtja ime atje nuk kishte asnjë status tjetër përveç se të dëshmitarit. Përmbajtja e dëshmisë është konfidenciale", - u shpreh Manjani.

ABUZIMI ME TENDERAT

Disa javë më parë, u vunë nën masë sigurie, 11 zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë, pas dyshimeve për abuzim

me 5 tenderët të dhënë në periudhën 2016-2017. Për drejtorin Ekonomik, Aurel Lamçe dhe specialistin e IT Arlind Alikaj gjykata ka ndryshuar masën e sigurisë nga arrest me burg në arrest shtëpie. Gjykata ka vendosur "arrest shtëpie" për Juliana Hoxhën, ish-sekretaren e Përgjithshme në MD. Gjithashtu, gjykata ka lënë në fuqi masën "arrest me burg" për specialistin tjetër të IT, Lusien Ali, i shpallur në kërkim. Për 8 zyrtarë të tjerë, u caktua masa "detyrim paraqitje". Sipas prokurorisë hetimet janë shtrirë në 5 tenderë si: Mirëmbajtja dhe mbikëqyrja e sistemit ICMIS në 7 Gjykatat Administrative, Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në

fushën penale, Përmirësimi, Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Regjistrimit Noterial Shqiptar, Sistemi i Monitorimit me kamera për burgun e Lezhës dhe Fushë Krujë, Përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemit elektronik të çështjeve të përbarimit.

Hetimet kanë zbuluar faktin se përmes shpërdorimit të detyrës, zyrtarët i kanë shkaktuar shtetit një dëm të madh financiar. Në fokusin e prokurorisë ishin funksionarët publikë që kanë qenë pjesë e njërive të prokurimit, komisioneve të vlerësimit të ofertave dhe komisioneve për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave. Tenderët janë zhvilluar në kohën kur Ministrinë e Drejtësisë e drejtuan Petrit Vasili dhe Ylli Manjani.



Drejtuësja e Krimeve të Rënda, Donika Prela dhe 6 prokurorë të tjerë aplikojnë për SPAK

TIRANË - Ndërsa gara për të kandiduar për tu bërë pjesë e Prokurorisë Speciale do të jetë e hapur deri sot, listës i është shtuar një emër i rëndësishëm. Donika Prela, drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda ka aplikuar dje të jetë pjesë e SPAK. Pak kohë më parë, ndonëse pati shumë akuzë, Prela arriti të kalonte vetingun e të konfirmohej në detyrë. Po dje, 6 prokurorë të tjerë kanë aplikuar për të qenë pjesë e SPAK. Ata janë prokurori i Apelit Tiranë, Altin Dumani, prokurorja Enkelelda Osmani, prokurorja në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, Elida Kackini (Celami). Gjithashtu, ka aplikuar për të qenë pjesë e SPAK edhe Enkelelda Milloani, Prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan. (Aktualisht me Urdhër të Prokurorisë së Përgjithshme është në pozicionin e Drejtuesit të kësaj Prokurorie) dhe Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, Maksim Sota. Pa ashtu ka aplikuar edhe Prokurorja e Krimeve të Rënda, Elisabeta Imeraj. Data e aplikimeve ishte fillimisht deri më 6 shkurt, por ky afat u shty deri më 21 shkurt pasi nuk kishte mjaftueshëm kandidatë. Deri më tani për të qenë pjesë e SPAK kanë aplikuar 23 prokurorë për 15 vende. Në institucionet e reja që pritet të formohen për llogari të reformës, pritsshmëria më e lartë publike është për SPAK, struktura e veçantë që do të hetojë dhe vendosë para përgjegjësisë politikanët dhe zyrtarët e lartë. Prokuroria e Posaçme (SPAK) i kryen funksionet e saj në mënyrë të pavarur, nëpërmjet prokurorëve të posaçëm, të cilët emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

TIRANË - Ramadan Hasa është një 67-vjeçar i cili jeton në kryeqytet. Ai është baba i 3 fëmijëve, 2 vajzave dhe një djali, por pas vdekjes së bashkëshortes disa vite më parë ka mbetur fare i vetëm. Vajzat jetojnë si emigrantë jashtë vendit ndërsa me të birin pas një bashkëjetese me të dhe nusen e tij pati konflikte. Ai thotë se ata nuk kujdeseshin për të, nuk i bënin ushqim edhe

"Nusja s'më shërben, djali më rrahu", i moshuari: Më çoni në azil

pse ju jepte para. Në debat e sipër me të birin situata agrivoi deri në konfrontim fizik dhe ai e denoncoi atë në polici për dhunë. Ka qenë vajza e cila e ka bindur që të tërhiqte denoncin dhe ta falte, por më pas djali ka vendosur të largohet nga banesa dhe të je-

tojë diku tjetër me qira. 67-vjeçari thotë se nuk jeton dot për veten ndaj në këto kushte ai kërkon ndihmën e shtetit që ta strehojë në një azil, në këmbim dëshiron të japë banesën e tij dhe pensionin e pleqërisë.

Vrasësi i të "fortit" të Tiranës, Naim Zyberi la qelinë më 14 shkurt

TIRANË

Lirimi me kusht i "Gjeneralit", Gjonaj pezullon nga detyra drejtorin e burgut të Drenovës

Ministrja e Drejtësisë: Vendimi i dhënë në kundërshtim me ligjin, të hetohet gjyqtari

Pak ditë pas lirimimit me kusht nga burgu të të dënuarit me burgim të përjetshëm, Gert Gjinari, i njohur si "Gjenerali", ka reaguar ministria e Drejtësisë, Eltida Gjonaj, e cila ka thënë se vendimi i dhënë është në kundërshtim me ligjin. Në një deklaratë për mediat, ministria ka theksuar se në kuadër të masave të marra, drejtori i burgut të Drenovës dhe dy vartës të tij janë kallëzuar në prokurori për këtë rast dhe se deri në zbardhjen e ngjarjes, këta zyrtarë janë të pezulluar nga detyra. "Nga hetimi rezultoi se vendimi, pavarësisht se nuk është i formës së prerë, është dhënë në kundërshtim me kriteret ligjore dhe kriteret e Kodit Penal. Për këtë arsye, Ministria e Drejtësisë i është drejtuar KLGJ-së dhe inspektoratit duke kërkuar procedim disiplinor për gjyqtarin që ka dhënë vendimin", është shprehur Gjonaj. Ndërsa, ka shprehur sigurinë se përgjigjja nga këto institucione do të jetë e shpejtë.

LIRIMI I "GJENERALIT"

45-vjeçari Gert Gjinari përfitoi liri me kusht më 14 shkurt nga Gjykata e Shkallës së Parë në Korçë, por prokuroria e mbajti edhe 48 orë të tjera në qeli, për shkak të gabimeve të konstatuara në vendimin e gjykatës. Pas korrigjimit të gabimeve, gjatë një seance të posaçme në gjykatën në fjalë, organi i akuzës nxori urdhrin e ekzekutimit dhe pas kryerjes së procedurave administrative nga burgu i Drenovës, Gjinari u la i lirë. Në vendimin e gjykatës



Ministria e Drejtësisë, Eltida Gjonaj

se qytetit juglindor, trupa gjyqkuese ka arritur në përfundimin se Gert Gjinari i plotëson të gjitha kushtet për lirim me kusht për dënimin, që nga sjellja shembullore, projektet e paraqitura për të ardhmen, fakti që është i gatshëm të riinte-grohet, marrëdhëniet e mira me trashëgimtarët e

viktimave e me radhë. Gjinari përfitoi lirim me kusht me të njëjtën procedurë abuzive që shpëtoi nga dënimin përjetë edhe Dritan Dajti, autor i vrasjes së 4 policëve. Ai u arrestua në Itali me akuzën për vrasjen e Naim Zyberit më 6 gusht të vitit 1997. Në një spital në Milano të Italisë, vrasje e kryer së bashku me mikun



Gert Gjinari

Viktima Naim Zyberi

e tij, Arben Grori. Ai u ekstradua në Shqipëri në vitin 2014, pas vendimit që gjykata italiane mori për dënimin e tij me burg përjetë. Por, 45-vjeçari duke shfrytëzuar gjykatat shqiptare ka kërkuar të hetohet në gjend-

jen që është dosja, duke përfituar uljen e dënimin në 25 vjet. Nuk kaluan më shumë se vetëm 5 vite nga ekstradimi, kur i akuzuari për vrasjen e bujshme kërkoi nga gjykata e Korçës lirimin me kusht.

PROCEDURA ABUZIVE

Gert Gjinari ka përfituar lirim me kusht me të njëjtën procedurë abuzive që shpëtoi nga dënimin përjetë edhe Dritan Dajti, autor i vrasjes së katër policëve. Ai u dënua me burgim të përjetshëm në Itali, por me sjelljen e dosjes në Shqipëri kërkoi gjykim të shkurrtuar, duke pranuar të gjitha aktet e akuzës, çka e çoi në dënimin përjetë në 25 vite burg. Një procedurë kjo e ndryshuar vitet e fundit, ku tashmë ndalohet gjykimi i shkurrtuar për vepra të rënda penale, veçanërisht për vendime me burgim të përjetshëm.

Shoqeria permbirimore JUSTITIA:


Shpall ankandin, faza I, për shitjen e pasurisë së paltajshme për të cilat ka vene hipoteke NGB BANKI/ABI BANK, me këto të dhëna:

1. Pasuria me numër 5/1-B2, sip 115 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B2, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 454, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 25.600 (njëzet e pesë mijë e gjashtëqind) Euro.
2. Pasuria me numër 5/1+1-28, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 28, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 448, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) Euro.
3. Pasuria me numër 5/1+1-47, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 47, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 458, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Euro.
4. Pasuria me numër 5/1-B1, sip 119.62m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, K. Nëntokë, B1, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 453, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 26.400 (njëzet e gjashtë mijë e katër qind) Euro.
5. Pasuria me numër 5/1+1-45, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 45, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 456, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 8,240 (tetë mijë e dyqind e dyzet) Euro.
6. Pasuria me numër 5/1+1-46, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 4, AP. 46, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 457, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 8,080 (tetë mijë e tetëdhjetë) Euro.
7. Pasuria me numër 5/1+1-49, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 4, AP. 49, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 460, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 17,520 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzet) Euro.
8. Pasuria me numër 5/1+1-44, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 44, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 447, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) Euro.
9. Pasuria me numër 5/1+1-43, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 43, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 446, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.
10. Pasuria me numër 5/1+1-25, sip 26.45 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 25, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 445, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 8,080 (tetë mijë e tetëdhjetë) Euro.
11. Pasuria me numër 5/1+1-26, sip 53.2 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 4, AP. 26, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 450, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 16,160 (gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Euro.
12. Pasuria me numër 5/1+1-48, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.3, SH. 1 K. 7, AP. 48, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 459, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.
13. Pasuria me numër 5/1+1-24, sip 27.01 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 24, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 451, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 8,240 (tetë mijë e dyzet) Euro.
14. Pasuria me numër 5/1+1-23, sip 59.1 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 23, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 452, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 18,000 (tetëmbëdhjetë mijë) Euro.
15. Pasuria me numër 5/1+1-22, sip 67.73 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 22, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 455, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 21,680 (njëzet e një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) Euro.
16. Pasuria me numër 5/1+1-27, sip 70.38 m2, ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 3126, me adrese P.2, SH. 1 K. 4, AP. 27, Shengjin, Lezhe, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr. 449, date 27.06.2007, në pronësi të z.Eduart Mark Ndociq. Në vlerën 20,080 (njëzet mijë e tetëdhjetë) Euro.

Ankandi zhvillohet në datën 22.02.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbasësyt gjyqësor. Adresa: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studio-justitia.com, tel. +355 4 2276990

Dyshohet se vrau shokun e tij në makinë, përfundon në pranga Roland Milo

TEPELENË - Roland Milo, autori i dyshuar për vrasjen e mikut të tij, Sokol Rama, është vënë në pranga ditën e djeshme nga policia e Tepelenës. Dy ditë më parë, burime zyrtare nga policia bënë me dije se Milo nga fshati Miçan i Frashërit në Përmet është bashkëpunëtor dhe i dyshuar për përshirjen e 32-vjeçarit në trafikun e lëndëve narkotike. Sokol Rama u gjet paraditen e së martës i vrarë me armë zjarri brenda në makinë, në zonën e



Roland Milo

Viktima Sokol Rama

Malëshovës, në vendin e quajtur "Përroi i Thellë". Trupi i 32-vjeçarit u gjet pas 2 javësh që nga momenti kur ishte shpallur i zhdukur nga familjarët. Ndërkaq, burimet e më-

sipërme pohuan se viktima dhe Milo janë në listën e personave me precedent penalë të mëparshëm për vjedhje dhe trafikim të lëndëve narkotike.

GJIROKASTËR - Gjykata e Apelit në Gjirokastrë ka lënë në burg pesë personat e arrestuar nga policia e Tepelenës si përgjegjës për grabitjen me armë dhe plagosjen e kambistit të palicencuar, Mustafa Mustafait dhe gruas së tij, në 22 janar në qytetin e Memaliaj. Policia e Tepelenës ka identifikuar brenda një kohe të shkurrtë autorët e grabitjes së dhunshme në Memaliaj. Gjykata ka vendosur burg për

Grabitja e kambistit në Memaliaj, Gjykata e Apelit lë në burg pesë të arrestuarit

Donaldo Nelajn, Dali Nelajn, Ari Isomatin, Armando Cakajn dhe Ervis Hysin. Kambisti 70-vjeçar Mustafa Mustafai nga Memaliaj u grabit me dhunë mbremjen e së martës të 22 janarit të këtij viti. Ngjarja ndodhi në dyqanin në pronësi të tij, në qendër të qytetit të Memaliajt. Pas kësaj ngjarjeje, poli-

cia e identifikoi grabitësin si një të ri rreth 1.95 m të gjatë dhe dyshimet ishin mbi një prej të huaj që prej disa ditësh kishte mbërritur në qytetin e Memaliaj. Grabitësi, i maskuar goditi në kokë 70-vjeçarin që mbeti pa ndjenja në tokë dhe më pas rrëmbeu portofolin me paratë dhe celularin.

Vlerësimi i testit për Fizioterapi, Mami, Teknik Laboratori e Imazheri

Zbardhen emrat e 206 fituesve, që aplikuan në "Infermierë për Shqipërinë"

Listat e plota me pikët për çdo kandidat në 6 qarqe

Voltiza Duro

Të gjithë ata që kanë aplikuar për një vend pune në portalin "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të njihen me pikët që kanë mundur të grumbullojnë gjatë testimit. "Gazeta Shqiptare" publikon sot emrat e 206 fituesve për 6 qarqe, përkatësisht atë të Fierit, Vlorës, Korçës, Elbasanit, Beratit si dhe Gjirokastrës. Respektivisht janë 38 fitues në fazën e parë për Fizioterapi, 105 kandidatë fitues për pozicionin Mami, 25 fitues në pozicionin Teknik Imazherie si dhe 35 fitues në pozicionin Teknik Laboratori, që aplikuan e u testuan në porta-

lin "Infermierë për Shqipërinë". Në testimin morën pjesë të gjithë kandidatët që janë kualifikuar në fazën e parë të konkurrimit nga vlerësimi i dosjes, kandidatët

që kanë marrë pjesë në testimin "Infermierë për Shqipërinë" të vitit paraardhës dhe që dëshirojnë të përmirësojnë rezultatit e tyre. Ndërkohë, testi përbëhej nga

dy pjesë: pjesa e parë përbante pyetje rreth akteve ligjore që rregullojnë kujdesin shëndetësor dhe profesionin e infermierit në Republikën e Shqipërisë dhe çështje që lid-

hen me etikën dhe komunikimin profesional në infermieri. Pjesa e dytë përbante pyetje rreth kujdesit infermior bazë dhe në specialitete. Vlerësimi përfundimtar i kan-

didatit është bërë me sistemin e 70 pikëve, i cili përbëhet nga pikët e pjesës së parë të testit (20 pikë) dhe nga pikët e pjesës së dytë të testit (50 pikë).

EMRAT ME 206 FITUESIT E INFERMIERISË

Nr.	Qarku	Specialiteti	Emër	Pikët	Nr.	Qarku	Specialiteti	Emër	Pikët
1	Berat	Fizioterapi	AJKUNA MYZAFER TELHAJ	47	103	Fier	Mami	FABJOLA FATMIR NITA (KOÇI)	41
2	Berat	Fizioterapi	DONALDA ASQERI KACELI	45	104	Fier	Mami	FILMONA ARGJË PROFIT(SALIAJ)	35
3	Berat	Fizioterapi	ELIS BAKI KUSHOVA	41	105	Fier	Mami	GERSIANA SABAT GREMI	38
4	Berat	Fizioterapi	IRDI FEJZI MULITA	47	106	Fier	Mami	INA NIKOLLAQ DUMI	39
5	Berat	Fizioterapi	MARDA NAMIK LUZI	46	107	Fier	Mami	JONIDA NIMET FERKO	32
6	Elbasan	Fizioterapi	ALBANA ISHREM MULLAHU	57	108	Fier	Mami	KLEVISA SKENDER RABJAJ	38
7	Elbasan	Fizioterapi	ANXHELA ARISTIDH AVDULI	54	109	Fier	Mami	LISIANA ALEKSANDER BOÇOVA	42
8	Elbasan	Fizioterapi	ELENI ANDREA KOCO	35	110	Fier	Mami	MALVINA TOMORR ÇEPELE	31
9	Elbasan	Fizioterapi	ERIDA SHKELQIM BLOGU	41	111	Fier	Mami	MARINELA FETI KANANI	42
10	Elbasan	Fizioterapi	ERJON SHKELQIM ÇELA	15	112	Fier	Mami	SHEGE ALI MAKOSINANI	43
11	Elbasan	Fizioterapi	JOLA FADIL XHARO	51	113	Fier	Mami	SILVIA SOKOL TATA	47
12	Elbasan	Fizioterapi	KLEAD BASHKIM GJYLA	47	114	Fier	Mami	SUZANA ARBEN ÇELA	41
13	Elbasan	Fizioterapi	LUBIANA LUAN BAKU	35	115	Fier	Mami	TISJANA TOPIK HOXHAJ	34
14	Elbasan	Fizioterapi	SERXHO PETRAQ PULLI	44	116	Fier	Mami	XHESIKA ISLAM HOXHA	21
15	Fier	Fizioterapi	ALKMEDA LUAN BYLAJ	34	117	Fier	Mami	ZARIDA FATOS ORAGA	40
16	Fier	Fizioterapi	EDA VANGJEL PRIFTI	45	118	Gjirokastrë	Mami	VALENTINA NEVRUZ RESO	29
17	Fier	Fizioterapi	ENDR VASIL PRIFTI	45	119	Gjirokastrë	Mami	VANESA NAPOLON LAZO	42
18	Fier	Fizioterapi	EUXHENIO FASLLI FAKAJ	30	120	Gjirokastrë	Mami	XHORXHINA BAJTJAR TUSUNI	46
19	Fier	Fizioterapi	EVELINA QEMAL HOXHAI	49	121	Korçë	Mami	ALDA YLI BILEZI	36
20	Fier	Fizioterapi	KOSTA ARIS BËDINI	42	122	Korçë	Mami	ANITA ALI BILBILI	37
21	Fier	Fizioterapi	KLODIAN LUTFI KULLOLL(MURAJ)	53	123	Korçë	Mami	BLERINA GURALI LUMI	36
22	Fier	Fizioterapi	MELITA HALIT ZEÇO	54	124	Korçë	Mami	ELENA ANGEJËLE BASHA(FILIP)	34
23	Gjirokastrë	Fizioterapi	XHULJAN FERIT KOLA	48	125	Korçë	Mami	ERJONA GEZIM SOPIA	38
24	Korçë	Fizioterapi	ADELAJDA FLORENC KUTROLLI	36	126	Korçë	Mami	JULIANA BUJAR HOXHALLARI	25
25	Korçë	Fizioterapi	ENI ARBEN ÇANGTARI	43	127	Korçë	Mami	KLAUDJA ADRIATIK ZENOLLARI	44
26	Korçë	Fizioterapi	GERALD GJERGJI GORARI	31	128	Korçë	Mami	KRISTINA HAXHI XHENGU	33
27	Korçë	Fizioterapi	ISIDA SOTIR CICI	47	129	Korçë	Mami	LAHE MEHMET BAJRAMI	51
28	Korçë	Fizioterapi	JORDIA AJRET SHKULAKU	53	130	Korçë	Mami	LAURA RAMADAN BINJAKU	27
29	Korçë	Fizioterapi	MARINELA VIT GJYSMA	50	131	Korçë	Mami	LEONIDA HYS DIMITRI	20
30	Korçë	Fizioterapi	MEGI FAIK SHULI	29	132	Korçë	Mami	MARIA ILIA TAHIRAJ	54
31	Korçë	Fizioterapi	MIRJANA NASI NIKOLLA	20	133	Korçë	Mami	MARSELA PETRIT LENJA	29
32	Korçë	Fizioterapi	RUDINA ALPREDI FODRA	47	134	Korçë	Mami	MARSELA NEBAI HAMOLLI	34
33	Korçë	Fizioterapi	XHULJANA ASTRIT ÇEZMALLI	54	135	Korçë	Mami	MEGI SAJLI CASU	31
34	Vlorë	Fizioterapi	ALMERIDA MEHMET ÇELOALLAJ	47	136	Korçë	Mami	RESMIE PETRIT HYKA	34
35	Vlorë	Fizioterapi	DIFMIR AJET MEMINAJ	48	137	Korçë	Mami	STILLIANA XHEMAL ÇENOLLI	39
36	Vlorë	Fizioterapi	KLODIAN NAIM LAME	27	138	Korçë	Specialiteti	Emër	Pikët
37	Vlorë	Fizioterapi	LUISIANA FADIL MEMUSHAJ	49	139	Vlorë	Mami	ERJON ASTRIT MEMELLI	36
38	Vlorë	Fizioterapi	ROMINA HYSNI SHEHAJ	48	140	Vlorë	Mami	ARJOLA BAJTJAR LUTO	41
39	Berat	Mami	ANXHELA PERPARIM HOXHA	42	141	Vlorë	Mami	DHURATA PETRIT HOXHAJ	51
40	Berat	Mami	ERLINDA NAZIF CIMO	42	142	Vlorë	Mami	ELORINA NUREDDIN NEVRAJ(PERAJ)	47
41	Berat	Mami	ROZETA GEZIM DOMI	48	143	Vlorë	Mami	XHESIANA FILLIM ÇELA	48
42	Berat	Mami	SOPIEJE JEMIN ZELO	29	144	Vlorë	Mami	XHEVAIRE EDMOND MEMINAJ(HALIRAJ)	39
43	Berat	Mami	VIOLE ROBERT STAVRI	43	145	Elbasan	Teknik Imazherie	ADELA REPAT PLAKU	48
44	Elbasan	Mami	MIRSEADA YEMAZAN BICA	44	146	Elbasan	Teknik Imazherie	ANDRE DHIMITER DEDJA	35
45	Elbasan	Mami	ADRIANA SAMI BOSHKU	40	147	Elbasan	Teknik Imazherie	ANISA ISLAM BEZATI	32
46	Elbasan	Mami	ALBANA HAZIZ FERZIU	33	148	Elbasan	Teknik Imazherie	ANISA SAIMIR ALLALLARI	37
47	Elbasan	Mami	ANASTASIA XHEVIT MENALLA	24	149	Elbasan	Teknik Imazherie	ANISA XHEVAIR MIMINI	42
48	Elbasan	Mami	ANASTASIA NIKOLLA PURIQI	47	150	Elbasan	Teknik Imazherie	ANISA XHEVAIR DESTILA	42
49	Elbasan	Mami	ANGJELINA BASHKIM LUKA	45	151	Elbasan	Teknik Imazherie	ELISABETA DHIMITER KORAJ	45
50	Elbasan	Mami	ANXHELA FIQIRI KOÇI(KABASHI)	45	152	Elbasan	Teknik Imazherie	ENXHI ARBEN SULCE	35
51	Elbasan	Mami	ARJOLA MERKUR TOCI	45	153	Elbasan	Teknik Imazherie	ERJON SPIRO KARAJ	35
52	Elbasan	Mami	ARTINA ALBERT SPAHO	55	154	Elbasan	Teknik Imazherie	ESTELA MUSTAFA BERRIU(TOÇILLA)	39
53	Elbasan	Mami	ARJAN PETRIT KASA	0	155	Elbasan	Teknik Imazherie	ILIR RAMADAN SHKEMBI	41
54	Elbasan	Mami	BERJONA BUJAR ALLIU	32	156	Elbasan	Teknik Imazherie	KLAUDJA GAZMEND GJIKOLLARI	47
55	Elbasan	Mami	BLERINA MUSTAFA QORRI	26	157	Elbasan	Teknik Imazherie	KRISTINA HAXHI XHENGU	33
56	Elbasan	Mami	DORINA ARIS ZHUPANI	30	158	Elbasan	Teknik Imazherie	NAJMI YLI MALIKU	16
57	Elbasan	Mami	EGLONTINA AGRON HAZMA	43	159	Elbasan	Teknik Imazherie	RAPE QERIM MANXHUKU	50
58	Elbasan	Mami	ELDA BEHTAR HAKAJ	43	160	Elbasan	Teknik Imazherie	SARA BAHIR GEGA	51
59	Elbasan	Mami	ELENA XHELADIN DURAKU(FRAKULLI)	40	161	Elbasan	Teknik Imazherie	XHEVAIRA SHARAN BRAKA	49
60	Elbasan	Mami	EMANUELA CLIRIM BASHALLI	39	162	Fier	Teknik Imazherie	ANESTI ASQERI ZYKA	39
61	Elbasan	Mami	EMANUELA FLAMUR BAJRAMI	41	163	Fier	Teknik Imazherie	ERALDO DASHNOR BELBA	28
62	Elbasan	Mami	ENTELA ARIF THARJA	51	164	Fier	Teknik Imazherie	GRETA FIQIRI HEMA	41
63	Elbasan	Mami	ERLIDA ARBEN LICI	40	165	Fier	Teknik Imazherie	MARIO BUJAR SALLAJ	41
64	Elbasan	Mami	ERISA AROLAND TERZIU	35	166	Gjirokastrë	Teknik Imazherie	ANA KUJTJM SHEHU	29
65	Elbasan	Mami	ERLINDA NAZIF CIMO	42	167	Gjirokastrë	Teknik Imazherie	KRISTIANA ASTRIT RUKA	41
66	Elbasan	Mami	ERLINDA NEJIM BOJA	40	168	Vlorë	Teknik Imazherie	EGLANTINA PETREFF HALILAJ	28
67	Elbasan	Mami	ESMERALDA SEJDIR KALLJA	30	169	Vlorë	Teknik Imazherie	ELSA RUSHIT ÇALLEKU	38
68	Elbasan	Mami	FJORALDA MISLIM HANA	51	170	Vlorë	Teknik Imazherie	GAZMIR FEJZI KUCAJ	25
69	Elbasan	Mami	FLORINA PERPARIM DISHA(GEGA)	43	171	Berat	Teknik Laboratori	ELDA MUSTAFA KAPLLANI	50
70	Elbasan	Mami	INJOLA HYSEN LALA	40	172	Berat	Teknik Laboratori	REXHINA BUJAR HAXHIU	47
71	Elbasan	Mami	IRNA ARBEN HYKA	42	173	Elbasan	Teknik Laboratori	AIDA ADRIATIK GJINI	45
72	Elbasan	Mami	IVA SAZAN ZHUPANI	44	174	Elbasan	Teknik Laboratori	ANDELA AGRON VESKA	45
73	Elbasan	Mami	JUXHINA FATMIR KURTEZI	58	175	Elbasan	Teknik Laboratori	DHAMANTINA FATOS MALOLLARI	43
74	Elbasan	Mami	KLODJANA JAKUP MARAJ	49	176	Elbasan	Teknik Laboratori	ELDA KUJTJM RUCI	44
75	Elbasan	Mami	LEDINA BEDI QOSJA	50	177	Elbasan	Teknik Laboratori	ENISELDA XHEVAHIR MENALLA	45
76	Elbasan	Mami	LUMTURIEJE MUSTAFA BRAZHDA	33	178	Elbasan	Teknik Laboratori	ENKELEDA AHMET BRACJA	49
77	Elbasan	Mami	MARJANA BEHTAR BICA	33	179	Elbasan	Teknik Laboratori	ERANDA ARBEN HASKJA	49
78	Elbasan	Mami	MARSIDA KUJTJM HOXHA	29	180	Elbasan	Teknik Laboratori	ERJON KURBAN KARASHI	47
79	Elbasan	Mami	MORENA ARIF BIBA	39	181	Elbasan	Teknik Laboratori	ETLEVA BUJAR SHARRA	54
80	Elbasan	Mami	SAFIE PETRIT TOPI	42	182	Elbasan	Teknik Laboratori	EVISA KOSTANDIN RANXHA	46
81	Elbasan	Mami	SANIE BEQIR KASA	50	183	Elbasan	Teknik Laboratori	LIRA ALEKSANDER TOLI	43
82	Elbasan	Mami	SILDA IBRAHIM KOLA	44	184	Elbasan	Teknik Laboratori	MARSELA MITHRIM KANACI	43
83	Elbasan	Mami	SONILA DASHAMIR CERRIKU	42	185	Elbasan	Specialiteti	Emër	Pikët
84	Elbasan	Mami	THELLEZA VEJZ SKENDER(CANI)	39	186	Elbasan	Teknik Laboratori	MEGI AQERI XIBRAKU	55
85	Elbasan	Mami	VANGJELICA HILIT XIBRAKU	45	187	Elbasan	Teknik Laboratori	MIRELA KUJTJM SHGUNI	38
86	Elbasan	Mami	XHENSILA FUAT KURTI	51	188	Elbasan	Teknik Laboratori	OLGAN FETAH BETI	45
87	Elbasan	Mami	XHENSILA YLLI KACI	36	189	Elbasan	Teknik Laboratori	VENEMIN ILR GEGA	52
88	Elbasan	Mami	XHULIANA HEJURAN BIKI	0	190	Elbasan	Teknik Laboratori	XHOANA MEHMET JAHU	50
89	Elbasan	Mami	XHULIANA FEIM SULA	0	191	Fier	Teknik Laboratori	YVONA ARBEN DULLA	49
90	Elbasan	Mami	ZAMIRA NAIM SHKALLA	33	192	Fier	Teknik Laboratori	ENXHI XHOXHI MAKA	55
91	Fier	Mami	AFERDITA BASHKIM ZAGRACI	36	193	Fier	Teknik Laboratori	GEZIME NJAZI METAJ	21
92	Fier	Mami	ALJONA RREMI HALLI	25	194	Fier	Teknik Laboratori	IZARA ARBEN DULLA	21
93	Fier	Mami	EMRUELA HASAN XHAFAJ	46	195	Fier	Teknik Laboratori	KRISTJANA XHEZMI PASHAJ	49
94	Fier	Mami	ANXHELA TODI ÇUKU	36	196	Fier	Teknik Laboratori	MIRLETA GANI IGRISHTI	35
95	Fier	Mami	DELINDA QAMIR HALITI	34	197	Fier	Teknik Laboratori	NAJADA PETRIT MYTARAJ	35
96	Fier	Mami	DENADA JOSIF GJECI	37	198	Fier	Teknik Laboratori	ORJADA SHEPITIM ÇEKAJ	42
97	Fier	Mami	ELENA HAMZA BEQIRAJ	48	199	Fier	Teknik Laboratori	SONILA SHKELQIM MILE	26
98	Fier	Mami	ENERALDA LUTJAR SHEPATARAKU	52	200	Fier	Teknik Laboratori	STELA PIRRO SHYTI	46
99	Fier	Mami	ERINDA FIQIRI GREMBI	85	201	Korçë	Teknik Laboratori	XHESI VIT GJYSMA	58
100	Fier	Mami	ERIOLE SABRI DRIZAKU	41	202	Korçë	Teknik Laboratori	ANISA PANAJOT ZACLLI	58
101	Fier	Mami	ERMELINDA DERVISH VELKANI	39	203	Korçë	Teknik Laboratori	BORANA ARBEN NAZERAJ	53
102	Fier	Mami	ESMERALDA ALBERT SULJO	42	204	Vlorë	Teknik Laboratori	KORÇE ADRIATIK KOZICI	53
					205	Vlorë	Teknik Laboratori	AULONA GAZO GJONI	49
					206	Vlorë	Teknik Laboratori	MERITA PETRIT HASANAJ	39
							Teknik Laboratori	MARJANA NAIM MALKA	54

Ekspertët: Ky hendek nuk mund të rikuperohet

Situata alarmante, bie me 6.2% numri i lindjeve në Shqipëri brenda një viti

Numri i lindjeve në vendin tonë për vitin 2018 ka rënë me 6.2%, krahasuar me 2017. Të dhënat janë bërë publike nga Instituti i Statistikave, sipas të cilit brenda një viti kanë lindur 28.934 bebe, ose 1935 foshnja më pak. Rënia me 6.2% e lindshmërisë ka ndodhur në qytetin e Korçës, ku lindjet në raport 2017-ën kanë rënë me 16 për qind, ndërsa në raport me censusin e 2011-ës, lindjet në këtë qark pësu- an rënie me 31 për qind. Si- pas autoriteteve lokale, Ko- rça po vuan nga tkurrja e popullsisë me shumë se gar- qet e tjera për shkak të kos- tove të larta që krijon dimri i gjatë. Pas Korçës, numri i

lindjeve pësoi rënie të madhe edhe në qarkun e Kukësit, ku bebet e lindura ishin 12% më pak se më 2017 ose 448 bebe më pak gjatë një viti. Për sh- kak se është qarku më i varfër në vend. Kukësi është përbal- lur me migracion të brendshëm dhe emigracion përgjatë gjithë periudhës së transicionit. Pas Korçës dhe Kukësit, qytetet e Fierit dhe Vlorës panë rënie të madhe të numrit të lindjeve me mbi 12 për qind, dy herë më shumë se mesatarja kombëtare prej

6.2%. Ulja në vijimësi e num- rit të lindjes po përkeqëson sh- tesën natyrore të popullsisë. Gjatë vitit 2018, shtesa naty- rorë e popullsisë është 7.130 banorë (lindje-vdekje), duke pësuar një rënie prej 17.4%, krahasuar me një vit më parë. Në tremujorin e katërt 2018, shtesa natyrore e popullsisë për 12 qarqet e Shqipërisë shënon vlerën më të lartë në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 1.089 numrin e vdekjeve. Me shtesë natyrore të lartë paraqitet

qarku i Elbasanit, me 273 lind- je më shumë se vdekje, pasuar nga qarku i Durrësit, me 248 lindje më shumë se vdekje. Shtesa natyrore e popullsisë në tremujorin e katërt 2018 regjistron vlerë negative vetëm në tri qarqe (Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë), ku vlera më e ulët shënohet në qarkun e Korçës, në të cilin numri i vdekjeve tejkalon me 154 numrin e lindjeve. Qarku i Gjirokastrës ka rezultuar me vlerë negative të shtesës naty- rorë të popullsisë gjatë gjithë



vitit, ku numri i vdekjeve ka- lon me 217 numrin e lindjeve, për vitin 2018. Ekspertët e de- mografisë e konsiderojnë alar- mante rënien e numrit të lind- jeve, pasi ky hendek nuk mund të rikuperohet, ndrë- she nga emigracioni që shpresat për rikthim ekzis- tojnë gjithmonë.

Voltiza Duro

Ogerta Manastirliu: Brenda shkurtit 300 specialistë të shtohen shërbimit spitalor

Premtimi i ministres: Rritje pagash me 7% për punonjësit e shëndetësisë

"Nisin punën 54 mjekë të rinj familjeje në mbarë vendin"

Duke filluar nga muaji prill do të nisë rritja e pagave me 7% për të gjithë punonjësit e shëndetë- sisë në vend. Lajmi është bërë me dije ditën e djeshme nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, gjatë një takimi me mjekët e rinj. Ajo u garantoi punonjësit të shëndetësisë se ky premtim do të përmbushet. "Duke filluar nga muaji prill, nis rritja e re e pagave 7% për të gjithë punonjësit e shën- detësisë", tha Manastirliu në fjalën e saj.

MJEKËT E RINJ

Ndërkohë, ditën e djeshme, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale priti 54 mjekët e rinj që u punësuan në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor në të gjithë ven- din. "Ju siguroj se kushtet e punës që do të gjeni sot në qen- drat shëndetësore janë shumë më të përmirësuara dhe më vjen mirë që ndër ju, shumë kanë zgjedhur të punojnë në qendra shëndetësore të largë- ta", tha Manastirliu. Sakaq, 54 mjekët e rinj të familjes janë fitues nga konkursi i shpallur nga Ministria e Shëndetësisë, për mjekë të përgjithshëm në kujdesin shëndetësor parësor. Nga Kukësi në Sarandë, mjekët e rinj do të plotësojnë në këtë mënyrë një pjesë të mirë të nevojave edhe në qendra shën- detësore të zonave të thella, si qendra shëndetësore Grykë Caje në Kukës, Fushë-Cidhe në Dibër, Zharrëz në Fier, Pishaj në Gramsh, Polican në Skrapar, e në shumë struktura të tjera të parësorit, për të shërbyer afër komunitetit, aty ku janë nevojat. Sipas të dhënave, plot 103 mjekë ap-



Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu gjatë takimit me mjekët e rinj.

likuan pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në një kohë që po vijon procesi i punësimit edhe me mjekët e qendrave shëndetë- sore në Tiranë.

SPECIALIZIMET
Gjatë takimit me mjekët e sapopunësuar, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka folur edhe mbi specializimet që janë drejt përfun- dimit. "Sa u takon spitaleve,

brenda muajit shkurt përfun- dojnë specializimet 300 mjekët e parë specialist (pas një bllokimi 4-vjeçar), të cilët do t'i shtohen shërbim- it spitalor në të gjithë ven- din", bëri me dije ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në deklar- aratën e saj.

REHABILITIMI I DISPANCERISË
Klinika e specializuar për



sëmundjet e mushkërive e qytetit të Tiranës, apo Dis- panceria, pas më shumë se dy dekadash është rehabili- tuar dhe pajisur me aparatu- ra mjekësore të reja. "In- vestimi në pajisjet digjitale të radiologjisë ka shkurtuar me 3 herë kohën e pritjes për shërbimet e speciali- zuara në këtë qendër. Me aparaturat e reja labora- torike është zgjeruar gama e

analizave, nga 3 që bëheshin më parë, në 16 lloje analiza- sh klinike, biokimike, bakte- riologjike dhe analiza speci- fike për sëmundjet e mush- kërive, duke garantuar shër- bimim e plotë laboratorik për pacientët", thotë ministrja e Shëndetësisë.

7%

RRITJA E PAGËS

Duke filluar nga muaji prill, do të nisë rritja e pagave me 7% për të gjithë punonjësit e shëndetësisë në vend. Lajmi është bërë me dije ditën e djeshme nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu. "Duke filluar nga muaji prill, nis rritja e re e pagave 7% për të gjithë punonjësit e shëndetësisë", tha Manastirliu në fjalën e saj.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përmbarimorë "E.G Bailiff Service" me përmbaues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 15.03.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i II-të për shitjen e 4 pasurive të paluajtshme në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K me vlera fillestare në ankand: a)176,867.6 (Njëqind e shtatëdhjet e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjet e shtatë pikë gjashtë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,795 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/66, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. b)171,172.4 (Njëqind e shtatëdhjet e një mijë e njëqind e shtatëdhjet e dy pikë katër) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,705 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/67, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. c) 221,480 (Dyqind e njëzet e një mijë e katërqind e tetëdhjet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3,500 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/72, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. d)94,920 (Nëntëdhjet e katër mijë e nëntëqind e njëzet) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1,500 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/73, Vol.19, Fq.147, ZK.2704 e ndodhur në Mjull-Bathore në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

"One Stop Shop" për qytetarët, marrëveshje bashkëpunimi mes Postës Shqiptare dhe ADISA-as

Posta Shqiptare dhe Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për ofrimin e të gjitha shërbimeve të Postës Shqiptare, pranë zyrave rajonale/vendore të ADISA, duke ofruar tashmë një "One Stop Shop" për qytetarët. Adminis-

tratori i Postës Shqiptare, Laert Duraj, u shpreh se ky "One Stop Shop" do të krijojë lehtësira të natyrës ekonomike dhe kohore për qytetarët, të cilët aplikojnë për marrjen e shërbimeve pranë zyrave të ADISA. Ai

theksoi se kjo marrëveshje bashkëpunimi do të shtri- het në të gjitha zyrat e ADISA, në të gjithë Shqipërinë, në një periudhë afatshkurtër. Ndërsa, drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve

Publike të Integruara, Lorin Ymeri theksoi faktin që kjo marrëveshje do të jetë një mundësi e mirë për lehtësimin e procedurave të shërbimeve që ofrohen nga ADISA dhe Posta Shqiptare.

Ndërtimet e paligjshme, miratohet fondi, formulari për të marrë kompensimin

Lista e re, 750 pronarët që marrin 552 milionë lekë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë

Publikohet lista me 750 pronarë që do të marrin kompensimin e pronarëve që u është zënë toka nga ndërtimet pa leje. Fondi i vënë në dispozicion është rreth 552 milionë lekë. Bëhet fjalë për ndërtimet pa leje në drejtoritë për ALUIZNI-t, përkatësisht në Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtetas, Vlorë, Durrës, Shkodër, Korçë, Kukës, Kavajë, Fshatra Turistikë dhe Kamëz, Vorë. Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave, vlera e kompensimit për 43 920,53 m² është 522 842 426,65 lekë. ATP publikon edhe formularin që duhet të plotësojnë përfituesit për të marrë kompensimin. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në gjithë vendin.

VENDIMI

Në vendim përcaktohet se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI si rrjedhojë e kalimit të pronësisë ndërmjet shitjes së parcelës ndërtimore si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. Qeveria përcakton se për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen nga ALUIZNI, si rrjedhojë e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes së parcelës ndërtimore, si për pasuritë shtetërore, edhe për pasuritë e të tretëve, në favor të objekteve informale që legalizohen. "Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht, në Tiranë, Elbasan, Durrës, Vlorë, Korçë, Kukës, Kavajë dhe Shkodër të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri, në regjistrat e pasurive të paluajtshme", përcakton me tej vendimi. Ndërkohë ngarkohen Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të

FORMULARI APLIKIMI
KOMPENSIM FINANCIAR PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE INFORMALE
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni:
Tel: (+355) 42 22 56 831 / 38
E-mail: info.atp@shqip.gov.al
Web: www.atp.gov.al

HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN

SHËNIM: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë. ME SHKRONJË TË MADHE E NË NGJYRË BLU.

SEKSIONI A: INFORMACIONI MBI APLIKANTIN

1. Emri
2. Mbiemri
3. Emri i Babait
4. NID (Nr. i identifikimit personal)
5. Gjinia Maskull Femër
6. Datëlindja
7. Vendlindja
8. Shtetësia
9. Adresa
10. Qyteti
11. Rrethi
12. Kodi Postar
13. E-mail
14. Nr. Tel. Celular
15. Nr. Tel. Fiks

SEKSIONI B: INFORMACIONI SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Subjekti përfutues
Emri i Babait
Mbiemri
Emri

17. Përfaqësuesi me prokurë i subjektit përfutues që paraqet kërkesën
Emri
Mbiemri
Emri i Babait

18. Adresa e subjektit përfutues ose e përfaqësuesit të tij me prokurë
Adresa
Qyteti
Rrethi
Kodi Postar
E-mail
Nr. Tel. Celular
Nr. Tel. Fiks

"Në përputhje me nenin 15/1 të ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, nenit 24 i ligjit 133/2015 "Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronarëve", si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 363, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale".
Në listën bashkëdhurorë të Këshillit të Ministrave Nr. _____ datë ____/____/____
Imbaj numrin rendor nga _____ deri _____ datë ____/____/____

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Kërkesa për kompensim e pronës sipas formatit Tip II që mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit e ATP-së www.atp.gov.al
 Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutues sipas radhës së trashëgimitarëve në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimit të lëshuara nga gjykatë për testamentin e bërë me akt notarial, të sille certifikatë familjare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie
 Prokurën e posaçme të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim ku, si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të marrëqar vlerën financiare në emër të tyre
 Vertetimin e lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogaritë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfutues, ku përcaktohet edhe numri i llogaritë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfutur
 Fotokopje të dokumentit të identifikimit si dhe certifikatën familjare të kërkuar
 Mandatpages që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit

Nëshkrimi i Aplikantit _____ datë ____/____/____
Nëshkrimi i Aplikantit _____ datë ____/____/____

KLAUZOLA DEKLARATIVE
Unë/Ne nënshkruar/ia _____ në dëgjim të përgjigjesive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta.
Nëshkrimi i Aplikantit _____ datë ____/____/____

Faksimile e formularit të aplikimit

Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi".
APLIKIMI
Procesi i regjistrimit apo pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 ditë pas datës së njoftimit publik. Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërbllimin

e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës. Grupi i punës brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës kryen verifikimet e duhura. Drejtori i përgjithshëm i ATP-së brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës nxjerr vendimin me

emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi dhe urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen. Gjithashtu, ai njofton edhe aplikantët që nuk përfitojnë në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes. Subjekti apo përfaqësuesi i tij me prokurë duhet të paraqesë pranë ATP-së, Tiranë, kërkesën-tip që i vihet në dispozicion nga grupi i

punës pranë AKKP-së, të plotësuar sipas rubrikave. Në listën e dokumenteve është dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfutues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Sipas ligjit, për dëshmitë e trashëgimitive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt notarial të sille certifikatë famil-

jare e personit për të cilin është lëshuar kjo dëshmi. Një tjetër dokument është prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të njëjës të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

DOKUMENTAT

Aplikimi për të marrë paratë dhe dokumentet ATP-ja në zbatim të VKM nr. 383/2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale" i ndryshuar, procedon si më poshtë:

- Njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.
- Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik.
- Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë paraqet pranë ATP-së gjithë dokumentacionin e lartpërmendur.
- Me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ATP-së ngrihet grupi i punës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave me objekt shpërbllimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale dhe shpërndarjen e fondit përkatës.
- Grupi i punës, brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për kompensimin e pronës, kryen verifikimet e duhura.
- Drejtori i përgjithshëm i ATP-së, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit nga grupi i punës: a) nxjerr vendimin me emrat e subjekteve që përfitojnë nga kompensimi; b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen; c) njofton kërkuarët që nuk përfitojnë në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mos përfshirjes.

Kompensimi i Pronarëve				Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
Emër	Atësi	Mbiemër		
AFERDITA	YMER	HASEQIU(HAXHIMUSA J)		
AGIM	YMER	HAXHIMUSAJ		
ANILA	MUSTAFA	KATRO(SHOPI)		
BURBUQE		STRUJU		
FERDINAND		STRUJU		
FLORINDA		FUGA(STRUJU)		
HATIXHE	MUSTAFA	SHOPI(KARKANAQE)		
HEDUJE	YMER	HAXHIMUSAJ		
LUMTURI		FUGA(STRUJU)		
MIMOZA	MUSTAFA	SHOPI(CEKA)		
MIRELA	MUSTAFA	SHOPI		
MYZEJEN		STRUJU		
SANUJE	YMER	BAKALLI(HAXHIMUSA J)		5,215,370.40
KRESHNIK	FRANK	UCAJ		
FLORA	XHAFERR	HASEKIU(LUCI)		
FISNIK	XHAFERR	HASEKIU		
ENGJIELL	XHAFERR	HASEKIU		
FEJME	SKENDER	HASEQIU		
MARSELA	BARDHUL	HASEQIU		
DORINA	BARDHUL	HASEQIU		
KRESHNIK	FRANK	UCAJ		1,412,974.80

Kompensimi i Pronarëve				Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
Emër	Atësi	Mbiemër		
ABULLA	DERVISH	BANJA		
BASHKIM	OSMAN	GJEVORI		
ENVER	SHEFKI	VRAPI		
FUAT	DERVISH	BANJA		
HEDUJE	SHEFKI	OGGA(VRAPI)		
IKBAL	DERVISH	LISI (BANJA)		
ISMAIL	DERVISH	BANJA		
ISUF	SHEFKI	VRAPI		
KUJTIM	SHEFKI	VRAPI		
LILIANA	SHEFKI	VRAPI		
LINDITA	HIQMET	SPAHIU		
NAZIF	DERVISH	BANJA		
NDRICIM	OSMAN	GJEVORI		
PULLUMB	HIQMET	SPAHIU		
RIZA	HIQMET	SPAHIU		
SHEFKAT	RIZA	ZHIPANI(SPAHIU)		
SHPPESA	HIQMET	SHYPPHEJA(SPAHIU)		
URIM	OSMAN	GJEVORI		2,963,800.00
HAXHI		ASLLANI		1,466,583.60
XHAFERR		HAXHIASLLANI		
DELIMET	MEHMET	BANGA		10,675,809.60

Kompensimi i Pronarëve				
Emër	Atësi	Mbiemër	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	
GAZMEND	DEMIR	PALLOSHI	612,672	
REFIK	AHMET	PALLOSHI		
SHEFIKAT	AHMET	GARUNIA(PALLO SHI)		
LIRI	AHMET	LADINOTI		
EMINE	AHMET	PALLOSHI		
AGIM	AHMET	PALLOSHI		
HAMDI	AHMET	PALLOSHI		
SHPETIM	AHMET	PALLOSHI		
FATIME	DEMIR	KARADAKU		
ALBANA	DEMIR	BALLICI		
GAZMEND	DEMIR	PALLOSHI	9,851,255.20	
REFIK	AHMET	PALLOSHI		
SHEFIKAT	AHMET	GARUNIA(PALLO SHI)		
LIRI	AHMET	LADINOTI		
EMINE	AHMET	PALLOSHI		
AGIM	AHMET	PALLOSHI		
HAMDI	AHMET	PALLOSHI		
SHPETIM	AHMET	PALLOSHI		
FATIME	DEMIR	KARADAKU		
ALBANA	DEMIR	BALLICI		
HASAN		KILA	9,408,344.40	
ARTAN	QEMAL	DARDHA	6,231,384.80	
VIOLETA	QEMAL	KADA		
MIMOZA	AVNI	ÇABIRI		
ARIAN	AVNI	STAROVA		
NAFTALIA		DOKSANI	19,029,847.60	
ZANA	LLAZAR	STATHI		
LILIANA	LLAZAR	KELLIÇI		
VERON	HASAN	DUMA		
MELITA	HASAN	DUMA		
LAZER	DHIMITER	PAPAJANI		
VENEMIN		JOSIFI		
ANILA		DEMIR(JOSIFI)		
ERNEST		NASTO		
AHMET	RAMAZAN	BYLYKBASHI		19,314,484.80
AHMET	RAMAZAN	BYLYKBASHI	68,925.60	
AHMET	RAMAZAN	BYLYKBASHI	1,295,546.00	
KUTJIM	EMIN	BAKALLI	10,009,528.80	
ZENEPE		SOULI		
ELDA	ISUF	RABETA(BAKALLI)		
ARDIAN		CANI		
MUSTAFA	DILAVER	CANI		
BIHANE		BAKALLI		
ALEMSHA	EMIN	ÇERRAGA(BAKALLI)		
VJOLLCA	SEID	BAKALLI		
BUJAR	EMIN	BAKALLI		
SHEGUSH	YMER	BIÇOKU		
MIRANDA	YMER	TOSKU		
ARDIT	YMER	KUÇI		
SAMIR	YMER	BAKALLI		
DALIP	KADRI	BAKALLI		
EDUART	MUSA	DUHANXHI	2,886,318.00	
IRMA	HAJRULLA	MURATI		
MEHMET	HYSEN	SHIJAKU		
MERDIJE	KAMBER	DUHANXHI		
RAMONDA	HYSEN	ÇOMO		
SHEFOET	KAMBER	DUHANXHI		
NAIM	SEFER	VATHI		2,886,318.00
SABRUE	MYRTEZA	DASHI		
XHEMILE	EMIN	VATHI		

Kompensimi i Pronarëve				
Emër	Atësi	Mbiemër	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	
SHPRESA	MUSA	DUHANXHI	9,893,376.40	
BURBUQE	HYSEN	XHEPA		
QAZIM	MUSA	DUHANXHI		
HYSEN	VELI	GJATA		
ISUF	KAMBER	GJATA		
ADEM		BAKALLI	6,219,897.20	
AISHE		BAKALLI		
ADEM		BAKALLI	117,428.80	
AISHE		BAKALLI		
LINDITA	ASTRIT	SANKHAKTARI	2,855,306.80	
ADELE		MIRAKU		
ARBEN	BARDHYL	MIRAKU		
ADNANT	BARDHYL	MIRAKU		
DANIELA	BARDHYL	MIRAKU		
SOKOL	ASTRIT	SANKHAKTARI		
MEVLUDE		MIRAKU		
FIQIRETE	SELIM	TABAKU		4,372,774.00
GEZIM	KASEM	TABAKU		
SADIK	KASEM	TABAKU		
ZEGJINE	TAHIR	TABAKU		
ARBEN		TABAKU		
BALKIIZE		TABAKU		
BARDHYL		TABAKU		
ISMAIL		ELEZI		
ERVALDO		TABAKU		
HAMDI		TABAKU		
HATLUE		TABAKU	10,518,908.40	
KUTJIM		TABAKU		
MIRANDA		TABAKU		
NEXHMIJE		TABAKU		
RINO		TABAKU		
SANIJE		TABAKU		
SKENDER		TABAKU		
ZENEPE		TABAKU		
BAKUSHE	ABDULLA	BODINAKU		10,518,908.40
BEDRIE		BODINAKU		
HYRUE	ABDULLA	DUKA		
NURUE	ABDULLA	MEZINI		
QAMILE	ABDULLA	LAÇI		
SEMIHA	ABDULLA	HUÇI		
SHYQYRI	ABDULLA	DERHEMI		
EGEREM	HAXHI	VATHI	8,737,621.20	
ERMIR	MEHMET	VATHI		
HATLUE	HAXHI	SHARRA		
HAXHI	MEHMET	VATHI		
NERIMAN	MEHMET	VATHI		
NEXHMIJE	MEHMET	VATHI		
QAMILE	HAXHI	VATHI		
XHAVIT	HAXHI	VATHI		
ARTUR	SEFER	VATHI		2,886,318.00
EDMOND	SEFER	VATHI		
FATMIRA	SEFER	SALKU		
HAMDE	MYRTEZA	VATHI		
HAXHIRE	MYRTEZA	VATHI		
LAJE	MYRTEZA	VATHI		
LUMTURI	SEFER	CIZMJA		
NAIM	SEFER	VATHI	2,886,318.00	
SABRUE	MYRTEZA	DASHI		
XHEMILE	EMIN	VATHI		

Kompensimi i Pronarëve				
Emër	Atësi	Mbiemër	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	
ADELA	XHEMIL	LLAGAMI	8,428,385.40	
ADNAN		LLAGAMI		
ALEKSANDRA		LLAGAMI		
ARTUR		LLAGAMI		
BEHIXHET	TAFAJ	LLAGAMI		
ERVIN		LLAGAMI		
MIRNIJE	XHEMAIL	LLAGAMI		
MYHYRUE		VERZIVOLLI		
NEXHAT		LLAGAMI		
SADETE	NEVZAT	LLAGAMI		
ADNAN		LLAGAMI	8,428,385.40	
ALEKSANDRA		LLAGAMI		
ARTUR		LLAGAMI		
ERVIN		LLAGAMI		
MYHYRUE		VERZIVOLLI		
NEXHAT		LLAGAMI		
BAKUSHE	MEHMET	KUSURI		810,818.40
BUKURUE	XHEMAL	CELNIKU		
FATMIR	XHEMAL	CELNIKU		
LEME	MEHMET	KUSURI		
LULIETA	XHEMAL	SALLAKU		
METUE	XHEMAL	KOCI		
MYRTEZA	XHEMAL	CELNIKU		
HAILE	MEHMET	KUSURI		
OSMAN	MEHMET	KUSURI		
QEFSERE	MEHMET	KUSURI		
RITA	SHERIF	FRASHERI	811,250.20	
HAXHIRE		LULI	54,510.20	
ARBEN		LULI		
HAXHIRE	ISLAM	LULI	135,173.80	
SELIM	RAMIS	LULI		
ARBEN	RAMIS	LULI		
ENQJELLUSHE	RAMIS	LULI		
PETRIT	KAMBER	CECA		
CERSI	PETRIT	CECA		
EUSABETA	NEXHIP	LULI		
PETRIT	MUSTAFA	LULI		
VJOLLCA	MUSTAFA	LULI		
FLORA	MUSTAFA	LULI		
FADIL		SHEHII	86,690.20	
ERMIRA		XHUNGA	14,571,860.00	
ERIND		XHUNGA		
GENC		XHUNGA	235,600.00	
JOVAN		PJESHKAZINI		3,693,176.00
MOISI		PJESHKAZINI		
JORGJI		PJESHKAZINI		
SAFUE		BLAKÇARI		8,701,200.00
FAHREOIN		TELI		
LUMNIE		DUSHI		
HASLIE		TELI		
ZYHRA		TELI		
AIDA		LEKRELLLO		
MIRIAN		TELI		

(vijon)

INSTAT: Më pak biznese në 2017-ën, numri i bizneseve aktive shënoi rënie

Biznesi i vogël në krizë, shitjet bien me 40 miliardë lekë

Numri i ndërmarrjeve aktive për vitin 2017 u ul me 0,8%

Biznesi i vogël po has jo pak vështirësi për të mbijetuar në tregun vendës. Të dhënat e fundit të Institutit të Statistikave tregojnë për rënie të shitjeve në bizneset familjare. Sipas INSTAT-it, gjatë vitit 2017, shitjet e bizneseve me 1 deri në 4 të punësuar kanë rënë me 40 miliardë lekë, ose me 16%. Rënie kanë pësuar edhe shitjet e bizneseve me 5 deri në 9 të punësuar. Për këtë kategori, tkurrja vlerësohet në 10%, ose me 19 miliardë lekë kundrejt një viti më parë. Bizneset e vogla zënë mbi 94% të totalit të bizneseve në Shqipëri. Kontributi i tyre është i madh, veçanërisht në drejtim të punësimit. Biznese familjare ose të vetëpunësuar, që sigurojnë të ardhura sa për të jetuar. Situata e tyre është vështirësuar, për shkak të rritjes së konkurrencës, por edhe shtimit të barrierave të ndryshme. Numri i ndërmarrjeve aktive për vitin 2017 ul me 0,8%.

INSTAT

Në vitin 2017, ndërmarrjet që operojnë në aktivitetet e prodhimit të mirave dhe shërbimeve realizuan 2.037 miliardë lekë shitje neto, duke rezultuar me 8,3% rritje, krahasuar me vitin 2016. Investimet e realizuara arritën vlerën 231 miliardë lekë nga 221 miliardë lekë në 2016-ën, duke shënuar rritje prej 4,7%. Në këtë periudhë, numri gjithsej i të punësuarve u rrit me 4,9%. Në prodhuesit e të mirave dhe shërbimeve operojnë 107.677 ndërmarrje aktive, duke shënuar një ulje me 0,8%, krahasuar me vitin 2016. Bazuar në të dhënat e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, kontributin më të madh në rritjen prej 8,3% të shitjeve neto e dhanë prodhuesit e shërbimeve me +5,4 pikë përqindje, të ndjekur nga prodhuesit e të mirave me +2,9 pikë përqindje. Gjatë vitit 2017, sektori i tregtisë zuri peshën më të madhe të shitjeve neto me 46,4%, i ndjekur nga sektori i ndërtimit dhe sektori i industrisë përpunuese me përkatesisht 11,9%. Sektorët me peshën më të vogël janë sektori i akomodimit dhe restoranteve (2,5%) dhe sektori i industrisë nxjerrëse (3,6%). Për treguesin e punësimit, prodhuesit e shërbimeve kanë kontribuar me +2,9 pikë përqindje, ndërsa prodhuesit e të mirave kanë kontribuar me +2,0 pikë përqindje. Sektori me përqindjen më të lartë të punësimit për vitin 2017 është sektori i tregtisë me 24,6% të punësimit, i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera (arsimi dhe shëndetësia private, shërbime administrative,

	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet	
	nr.	%	nr.	%	min Lekë	%	min Lekë	%
Gjithsej	107.677	100,0	492.913	100,0	2.037.349	100,0	231.713	100,0
1-4 të punësuar	94.834	88,1	150.032	30,4	240.336	11,8	22.245	9,6
5-9 të punësuar	6.761	6,3	42.785	8,7	175.394	8,6	9.623	4,2
10-49 të punësuar	4.839	4,5	95.574	19,4	665.779	32,7	41.815	18,0
50+ të punësuar	1.243	1,2	204.521	41,5	955.840	46,9	158.030	68,2


NDËRMARRJET E MBYLLURA

Numri i ndërmarrjeve aktive për vitin 2017 u ul me 0,8%. Prodhuesit e shërbimeve kontribuan me -0,6% në uljen e numrit të ndërmarrjeve aktive dhe prodhuesit e të mirave me -0,2%. Sektori me numrin më të madh të ndërmarrjeve është ai i tregtisë (41,4%) i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera (20,8%) dhe sektori i akomodimit dhe restoranteve (18,2%). Gjatë vitit 2017, sektori i industrisë nxjerrëse pati numrin më të vogël të ndërmarrjeve aktive, të cilat zunë 0,5% të ndërmarrjeve aktive gjithsej.

profesionale, shkencore dhe teknike etj.) me 21,4% dhe nga sektori i industrisë përpunuese me 20,3% të të punësuarve gjithsej. Gjatë vitit 2017, investimet u rritën me 4,7%, ku prodhuesit e të mirave kontribuan me +0,7

pikë përqindje dhe prodhuesit e shërbimeve kontribuan me +4,0 pikë përqindje. Prodhuesit e shërbi-

meve zunë 30,9% të investimeve nga 28,3% që zinin vitin e kaluar. Sektori me vlerën më të lartë të investimeve të realizuara është sektori i energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve, i cili për vitin 2017 ka investuar 71 miliardë lekë duke zënë 30,6% të investimeve gjithsej. Peshën më të vogël të investimeve e zënë sektorët e akomodimit dhe restoranteve (2,6%) dhe transporti, informacioni dhe komunikacioni (5,7%).



Pronat, Avokatura e Shtetit unifikon praktikën me zyrat vendore kur palë është ATP-ja

Avokatura e Shtetit njoftoi së fundmi se ka unifikuar procedurën e saj të mbrojtjes në lidhje me legjislacionin e pronave, ku palë e përfshirë është Agjencia e Trajtimit të Pronës. Referuar detajeve të dhëna nga ky institucion, në muajt janar dhe shkurt janë zhvilluar takime me zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit për të trajtuar problematikat që hasen nga zbatimi i praktikave gjyqësore pas miratimit të legjislacionit që lidhet me trajtimin dhe kompensimin e pronës. "Për herë të parë që pas miratimit të ndryshimeve ligjore të legjislacionit të pronës, me mbështetjen e projektit "Mbështetja e mjeteve juridike efektive vendëse dhe lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve në Shqipëri", i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Europian dhe programi i Këshillit të Europës nën titullin "Instrumenti horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" dhe zbatohet nga Këshilli i Europës, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, mbledhi në tri tavolina të rrumbullakëta të gjitha zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit dhe ekspertë të fushës të së drejtës për trajtimin e të gjitha problematikave të dala nga zbatimi në praktikë gjyqësore e administrative i Ligjit Nr. 133/2015 për "Trajtimitin e pronës dhe finalizimin e procesit të kompensimit të pronësive".



Taksimi i biznesit

Shqipëria, e 120-ta në botë ndër 171 shtete

Shqipëria është e 120-ta në botë, ndër 171 shtete sa i përket taksimit mbi biznesin. Krahasimi është bërë duke llogaritur si bazë taksën korporative, e cila në vendin tonë fiksohet në 15%. Por, në konsideratë merren edhe taksat të tjera, të cilat jo të gjitha vendet i kanë njësoj dhe të cilat disa shtete i kanë në zero. Siç duket qartë edhe nga grafiku, Shqipëria ka një taksë korporative më të lartë se vende si Japonia, Norvegjia apo edhe Mbretëria e Bashkuar. Nga lista janë hequr vendet në të cilat kjo taksë fiksohet në zero. Në krahasim me rajonin ndërkohë, Shqipëria është e para bashkë me Serbinë, ku norma e taksimit korporativ fiksohet në 15%. Ndërkohë që për të gjitha vendet e tjera taksat zbriten pranë 10%, me përjashtim të Malit të Zi, ku zbritet në 9%. Në nivel global ndërkohë, në vend të parë renditen Emiratet e Bashkuara Arabe, me një normë në 55%, ndërkohë që nga krahu i kundërt i tabelës është Uzbekistani, në 7,5%. Klasifikimi bëhet edhe në bazë të kontributeve. Në këtë drejtim, Shqipëria me një normë po në 15% renditet e 48-ta në botë, si dhe e dyta në rajon pas Serbisë, që ka një normë në 17,9%.

MARRËVESHJA



Ministria e Financave do të ofrojë 266 pozicione praktikash

Ministria e Financave ka nënshkruar ditën e sotme një marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Ekonomik, në kuadër të Paktit për Universitetin. Përmes kësaj marrëveshjeje, sipas ministres së Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, MFE do të ofrojë 266 pozicione praktikash, përfshirë institucionet e varësive për studentët e këtij fakulteti. Ndërkohë, në portalin "punëtmbarë.al" janë hapur aktualisht 203 vende vakante dhe 44 pozicione janë shpallur vakante jashtë shërbimit civil. Po ashtu, sipas ministres Denaj, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe kërkimit shkencor. "Kërkimi shkencor zë gjithashtu një vëmendje të veçantë për ne, ndaj dhe do të mbështesim universitetin që nëpërmjet tërheqjes së granteve nga donatorët, aplikim të përmes fondeve ndërkombëtare dhe bashkëpunimit me sektorin privat të mund të ofrojë konsulentë e tij cilësorë në një sërë sektorësh jetikë për vendin". Në këtë kuadër, Denaj njofton se është ngritur edhe zyra e bashkëpunimit brenda ministrisë si një platformë komunikimi me studentët dhe pedagogët e këtij fakulteti.

Rrëfëhet këngëtarja: Jeta ime mes muzikës dhe sëmundjeve, ja si arrita të luftoja

Nertila Haxhia:

Unë, Elita 5 dhe Shkumbini do të jemi tre muskëtjerët e rock baladave

"Ëndrrat kthehen shpesh në thesar të humbur po nuk luftove"

Egla Xhemali

Nertila Haxhia, e njohur me emrin artistik, Lissus Tilka, është e reja më interesante që mund të veçosh në shoqërinë shqiptare. Intellektuale, e përgatitur fort, autore e romaneve të krrimit të organizuar, aktiviste e të drejtave të njeriut e së fundmi po shkëlqen edhe si kantautore e baladave dhe repit. Cilësitë e shumta dhe këmbëngulja e kësaj vaje për të realizuar ëndrrat e saj me shumë punë e sakrificë, e sidomos suksesi me baladën e fundit "Më lini ta harroj" si dhe bota përtej muzikës vijnë në një rrëfim për "Gazeta shqiptare". Përtej shkëlqimit të dritave ajo personifikon vajzën e sakrificave që ka arritur gjithçka me shumë punë dhe pasion. Nertila na tregon për sëmundjen që arriti ta luftonte, për mënyrën se si e përballoj fazën delikate si dhe për krahasimin që i bëjmë me "Elita 5" dhe Shkumbinin. Ndër të tjera Haxhia pohon se për të nuk ka ekstreme në muzikë. Repi dhe roku janë si një energji e brendshme, së cilës nuk mund t'i shmangesh pa performuar.

Ndihesh më mirë kur të flasim si Nertila apo Lissus Tilka?

Së pari, faleminderit që zgjodhët të intervistonit përcjelljen e imazhit të të dyjave. Mund të them vetëm se Nertila po punon fort për të realizuar ëndrrat e Lissus Tilkës. Janë të dyja pashmangshmërisht të lidhur me njëra-tjetrën. Ndryshimi i vetëm është se Lissus është gjithmonë pak më artistike në shfaqjen e kuazave të saj, ndërkohë që Nertila i përkëtohet familjes dhe shoqërisë që ka nevojë për punë reale për të mbijetuar, jetuar dhe zhvilluar. Nertila ka vuajtur më shumë se Lissus. Lissus po ndërtohet mbi gërmallat e dhimbjes së Nertilës, shumë vajzave shqiptare dhe ëndrrat e vjetra të lëna në mes



nga heshtja që vret gjithçka përveçse kohës dhe mundësi që ajo të jep herë pas here.

Kohët e fundit po të shohim në projekte gjithmonë e më të mira muzikore. Çfarë po bën Nertila më tepër sesa Lissus në muzikë?

Nertila po praktikon mësimdhënien si praktikë shkollimi e aftësimi akademik të mëtejshëm, po menaxhon duke punuar ditë e natë e sidomos, po qëndron më afër se asnjë ëndrre, atij



realiteti që apo ka bërë kryevepër në jetë: Celestina, ime bije! Kam preferuar që në vitet e para të jetës së saj, ti kushtoj gjithçkajë më pak rëndësi edhe sikur të humb shumë mundësi reale, ndoshta edhe që nuk mund të e vijnë me në të njëjtën formë. Ama Celestina nuk ka as formë, as përmbajtje të dytë, sepse ajo është dashuria e vërtetë!

Kënga jote e fundit "Më lini ta harroj," ka fituar shumë zemra këto ditë, e si rezultat duket sikur fansat



e tu janë shtuar. A po e ndjen aromën e famës?

Unë jetoj për njeriun. Unë këndoj, jetoj e krijoj si njeri, e kjo më ushqen shpirtin artistik. Veproj si njeri e jo si njeri i famshëm apo kandidat për njeri të famshëm. Nëse të qenit njeri punëtor, me këmbë në tokë e me talent, do të bëjë që fama të më vij mbrapa, atëherë le të vij. Le të vijë, por Lissus do ta mbajë gjithmonë mbrapa!

Nertila t'i shumë vite ke luftuar me dy sëmundje të rënda që të kanë rrezikuar jetën. Ku e ke gjetur motivimin që të bësh kaq shumë gjëra?

Tek Zoti, vetja dhe sytë e time bije. Zoti që s'më braktisi në asnjë iniciativë timen e më dha vullnet për të besuar te vetja. Duke punuar vetë mblodha akoma më shumë forca dhe ia dola të mendoj se më shumë sesa sëmundje, unë kam gjëra për të bërë në jetë. Dhe vajza, sytë e saj nuk meritojnë asgjë veç buzëqeshjeve. Nëse nuk bëja unë gjithçka për ta bërë të lumtur, që mos të më shihte e lënduar, e sëmurë, kush do ta bënte veç nënës së saj?

Nertila shpesh mediat të kanë cilësuar në zë, tekste e muzikë si sozia e Elita 5 dhe Shkumbin Ismailit. Si je ndierë nga këto komente?

Kam ndierë lot në sy, sepse janë dy këngëtarë që i dua më shumë në zhanrin që unë kam të parin në krijimtarinë e referencat e mia. Shpresoj që një ditë këngët e mia të dëgjojnë me të njëjtën nostalgji si këngët e tyre, dhe pse jo, në të ardhmen të mos më quajnë sozi, por unë, Elita 5 dhe Shkumbini do të jemi tre muskëtjerët e rock baladave!

Një mesazh për artistët e rinj?

Ëndrrat kthehen shpesh në thesar të humbur. Kujtohuni se në çdo stinë, toka punohet në forma të ndryshme! Qielli merr ngjyra të ndryshme! Uji nuk ka të njëjtën temperaturë! Ju punoni që dielli ditën të shkëlqej kur është ftohtë, e hëna të dalë kur vjet të duken të pafundmë. Një ditë, ju do krijoni universin tuaj unik!

Ti këndon më së shumti balada rock dhe rap. Si ka mundësi dy shije kaq në ekstrem?

Nuk janë ekstrem tek unë. Me baladat shfaq brishtësinë dhe forcën që vjen nga pjesa më e bukur e dhimbjeve më të mëdha, ndërsa me rap kam më potencial që të shfaq në tekste karakterin rebel të aktivistes që këndon më së shumti për të ngritur figurën jomateriale të njerëzve e sidomos fuqizimin e figurës së grave.

Unë këndoj, jetoj e krijoj si njeri, e kjo më ushqen shpirtin artistik. Veproj si njeri e jo si njeri i famshëm apo kandidat për njeri të famshëm. Nëse të qenit njeri punëtor, me këmbë në tokë e me talent, do të bëjë që fama të më vij mbrapa, atëherë le të vij. Le të vijë, por Lissus do ta mbajë gjithmonë mbrapa!

Nertila t'i shumë vite ke luftuar me dy sëmundje të rënda që të kanë rrezikuar jetën. Ku e ke gjetur motivimin që të bësh kaq shumë gjëra?

Tek Zoti, vetja dhe sytë e time bije. Zoti që s'më braktisi në asnjë iniciativë timen e më dha vullnet për të besuar te vetja. Duke punuar vetë mblodha akoma më shumë forca dhe ia dola të mendoj se më shumë sesa sëmundje, unë kam gjëra për të bërë në jetë. Dhe vajza, sytë e saj nuk meritojnë asgjë veç buzëqeshjeve. Nëse nuk bëja unë gjithçka për ta bërë të lumtur, që mos të më shihte e lënduar, e sëmurë, kush do ta bënte veç nënës së saj?

Nertila shpesh mediat të kanë cilësuar në zë, tekste e muzikë si sozia e Elita 5 dhe Shkumbin Ismailit. Si je ndierë nga këto komente?

Kam ndierë lot në sy, sepse janë dy këngëtarë që i dua më shumë në zhanrin që unë kam të parin në krijimtarinë e referencat e mia. Shpresoj që një ditë këngët e mia të dëgjojnë me të njëjtën nostalgji si këngët e tyre, dhe pse jo, në të ardhmen të mos më quajnë sozi, por unë, Elita 5 dhe Shkumbini do të jemi tre muskëtjerët e rock baladave!

Një mesazh për artistët e rinj?

Ëndrrat kthehen shpesh në thesar të humbur. Kujtohuni se në çdo stinë, toka punohet në forma të ndryshme! Qielli merr ngjyra të ndryshme! Uji nuk ka të njëjtën temperaturë! Ju punoni që dielli ditën të shkëlqej kur është ftohtë, e hëna të dalë kur vjet të duken të pafundmë. Një ditë, ju do krijoni universin tuaj unik!

Ti këndon më së shumti balada rock dhe rap. Si ka mundësi dy shije kaq në ekstrem?

Nuk janë ekstrem tek unë. Me baladat shfaq brishtësinë dhe forcën që vjen nga pjesa më e bukur e dhimbjeve më të mëdha, ndërsa me rap kam më potencial që të shfaq në tekste karakterin rebel të aktivistes që këndon më së shumti për të ngritur figurën jomateriale të njerëzve e sidomos fuqizimin e figurës së grave.

Nertila shpesh mediat të kanë cilësuar në zë, tekste e muzikë si sozia e Elita 5 dhe Shkumbin Ismailit. Si je ndierë nga këto komente?

Kam ndierë lot në sy, sepse janë dy këngëtarë që i dua më shumë në zhanrin që unë kam të parin në krijimtarinë e referencat e mia. Shpresoj që një ditë këngët e mia të dëgjojnë me të njëjtën nostalgji si këngët e tyre, dhe pse jo, në të ardhmen të mos më quajnë sozi, por unë, Elita 5 dhe Shkumbini do të jemi tre muskëtjerët e rock baladave!

Një mesazh për artistët e rinj?

Ëndrrat kthehen shpesh në thesar të humbur. Kujtohuni se në çdo stinë, toka punohet në forma të ndryshme! Qielli merr ngjyra të ndryshme! Uji nuk ka të njëjtën temperaturë! Ju punoni që dielli ditën të shkëlqej kur është ftohtë, e hëna të dalë kur vjet të duken të pafundmë. Një ditë, ju do krijoni universin tuaj unik!

Ti këndon më së shumti balada rock dhe rap. Si ka mundësi dy shije kaq në ekstrem?

Nuk janë ekstrem tek unë. Me baladat shfaq brishtësinë dhe forcën që vjen nga pjesa më e bukur e dhimbjeve më të mëdha, ndërsa me rap kam më potencial që të shfaq në tekste karakterin rebel të aktivistes që këndon më së shumti për të ngritur figurën jomateriale të njerëzve e sidomos fuqizimin e figurës së grave.

Thaçi: Nuk më duhet vota, Kosova do dalë fituese

Tarifa ndaj Serbisë, Vuçiç kërkon ndihmën e BE: Detyroni Kosovën të heqë taksën

Presidenti Hashim Thaçi deklaroi dje se Kosova është me fat që ka një përkrahje unike nga SHBA dhe nga të gjitha institucionet e saj pa asnjë dallim. Komentet Thaçi i bëri në "Women in Energy Scholarship Program", ku tha se mbështetja amerikane do të arrijë qëllimin nëse Kosova është në paqe me vetveten dhe fqinjët e vet, pasi asnjë investitor nuk vjen në rajon nëse flitet për luftë. Thaçi theksoi se SHBA është e fokusuar për të ndihmuar Kosovën në arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Serbinë. "Ën-



drra e Kosovës shtet i suksesshëm e prosperues arri-

ALEKSANDAR VUČIČ

"Ëndrra e Kosovës shtet i suksesshëm e prosperues arrihet vetëm nëse dalim nga gjendja e status-qou-në. E di që nuk fitohen shumë vota kur flitet për dialog, mua nuk më duhet vota", - ka thënë Vuçiç.

het vetëm nëse dalim nga gjendja e status-qou-në. E di që nuk fitohen shumë vota kur flitet për dialog, mua nuk më duhet vota. Interesi nacional është mbi vota. Uroj që këto investime të MCC në të mirë të qytetarëve të rriten të shumëfishohen në arritjen e objektivave që kemi me

SHBA. Jam i bindur se Kosova do të dalë fituese dhe gratë që do të fitojnë nga këto burra, do të kthehen me sukses më të madh", tha ai. Ndërkohë presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç është takuar dje me shefin e delegacionit të Bashkimit Evropian, ambasadorin Sam Fabrici. Vuçiç i ka thënë Fabricit se shpreson që BE-ja të bëjë përpjekje shtesë për të detyruar Prishtinën të tërheqë taksën 100 për qind pasi kjo sipas tij kërcënon paqen dhe stabilitetin në rajon. "Ka nevojë për një marrëveshje të qëndrueshme. Ne jemi të gatshëm të vazhdojmë bisedimet me Prishtinën kur taksa të shfuqizohet", ka deklaruar presidenti serb. Ai ka shtuar se Beogradi është gati

të gjejë një zgjidhje kompromisi duke theksuar se nuk ka alternativë për dialogun midis Beogradit dhe Prishtinës. Bashkëbiseduesit kanë diskutuar për rrugën evropiane të Serbisë, problemet me dialogun Beograd-Prishtinë, zbatimin e reformave politike dhe ekonomike si dhe problemet globale. Vuçiç ka thënë se Serbia duhet të vazhdojë rrugën e saj evropiane dhe kjo është shumë e rëndësishme për t'u mbështetur më tej nga BE-ja. Fabrici ka theksuar se BE-ja do të vazhdojë të ndërmeretoje dialogun në mënyrë që të arrihet marrëveshje gjithëpërfshirëse me Beogradit dhe Prishtinës.

Ish-kancelari gjerman apel Prishtinës: Hiqni taksën ndaj Serbisë

Takimi Pahor-Mogherini, diskutohet zgjidhja "jashtë kutisë" për Kosovën

Rusia: S'e kemi ndryshuar qëndrimin për Kosovën

Ditën e djeshme presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor ka rënë dakord se trajtimi i situatës në Kosovë duhet, gjithashtu, të lejohet zgjidhja "jashtë kutisë". Megjithatë, siç shkruan Agjencia e Lajmeve Sllovene - STA, ai ka thënë se një zgjidhje e tillë nuk duhet të bazohet në parimin etnik. Një mendim i tillë, Pahor e ka dhënë bashkë me shefen e Politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Gjatë diskutimeve, thuhet se dyshja ka diskutuar edhe rreth Venezuelës për të cilën çështje kanë vlerësuar se një përdorim i forcës ushtarake për ndryshim është i papranueshëm. Një deklaratë rreth Kosovës, presidenti slloven e kishte dhënë edhe gjatë një vizite, ditë më parë në Beograd, pas takimit me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiç. "Zgjidhja e problemeve mes Serbisë dhe Kosovës përmes korrigjimit të kufijve kërkon shumë mençuri. Procesi nuk mund të sjellë dëme kolaterale për vendet e tjera në rajon. Është një mendim shumë i guximshëm, nuk do ta hidhja poshtë, por që do të isha shumë i kujdesshëm lidhur me këtë çështje", kishte deklaruar Pahor. Ish-kancelari gjerman Gerhard Shreder ka komentuar zhvillimet e fundit për çështjen e Kosovës. Ndërkohë ish-kancelari gjerman Gerhard Shreder ka deklaruar se është reale që Serbia më 2025 të hyjë në Bashkimin Evropian. Por, ai shtoi se Prishtina duhet ta heqë vendimin për taksë ndaj mallrave serbe dhe se ky është parakushti që



Presidenti i sllovenisë, Borut Pahor dhe Federica Mogherini

BORUT PAHOR

"Zgjidhja e problemeve mes Serbisë dhe Kosovës përmes korrigjimit të kufijve kërkon shumë mençuri. Procesi nuk mund të sjellë dëme kolaterale për vendet e tjera në rajon. Është një mendim shumë i guximshëm, nuk do ta hidhja poshtë, por që do të isha shumë i kujdesshëm lidhur me këtë çështje", kishte deklaruar Pahor.

palët të rikthehen në tavolinën e negociatave. "Absolutisht mendoj se vendimi për taksë është gjë e keqe. Mendoj se ato do të hiqen dhe nuk është vetëm mendim i imi personal, por mendim i Bashkimit Evropian dhe shteteve tjera se kjo duhet të ndodhë", u shpreh Shreder. Shreder, i cili gjatë vizitës së tij në Serbi do të takohet me presidentin Aleksandar Vuçiç për të biseduar për mundësinë ekonomike dhe politike në Serbi, ka thënë se është e nevojshme të arri-

het një marrëveshje me Beogradit dhe Prishtinës. "Dialogu ishte duke shkuar me rrjedhë të mirë. Por, pastaj erdhi taksa. Shpresoj se do të hiqet në mënyrë që të arrihen marrëveshje të caktuara për të cilat kemi dëgjuar në fillim të bisedimeve", theksoi ai. Nga ana tjetër, Moskë nuk e ka ndryshuar qëndrimin ndaj Kosovës, ka thënë zëdhënësjë e ministrisë së Jashtme të Rusisë, Marija Zaharova. "Pozicioni ynë nuk ka ndryshuar", i tha Zaharova

GERARD SHREDER

"Absolutisht mendoj se vendimi për taksë është gjë e keqe. Mendoj se ato do të hiqen dhe nuk është vetëm mendim i imi personal, por mendim i Bashkimit Evropian dhe shteteve tjera se kjo duhet të ndodhë", -u shpreh Shreder.

va agjencisë 'Beta', kur u pyet lidhur me deklaratat e ministrit të Jashtëm të Serbisë, Ivica Dačić, se "vënia e kufirit mes shqiptarëve dhe serbëve është kërkesë zyrtare e Beogradit në dialogun me Prishtinën". Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin pati deklaruar gjatë vizitës në Beograd se Moskë pajtohet për arritjen e një marrëveshjeje mes Prishtinës dhe Beogradit në "kuadër të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së". Për pozicionin e Rusisë në raport me arritjen e një marrëveshjeje për normalizimin e raporteve mes Kosovës dhe Serbisë pati folur edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ai në nëntor të vitit të kaluar, takoi Putinin në Paris dhe përmes një postimi në 'Facebook' tha se Rusia do të "mbështesë" marrëveshjen Kosovë-Serbi.

Presidenti kosovar: Moskorrigjimi i kufijve destabilizon rajonin

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi në konferencën me temën "Zëri i Popullit rreth 'Finale të Madhe' ndërmjet Kosovës dhe Serbisë", ka thënë se normalizimi i raporteve Kosovë-Serbi është i pamshangshëm. Thaçi u shpreh se ndonëse 20 vite nga përfundimi i luftës së fundit, Kosova dhe Serbia ende nuk kanë arritur një marrëveshje të mirëfilltë që do të



arritte paqen. Presidenti theksoi se ka ardhur koha që të lihen prapa armiqësitë dhe të bëhet marrëveshja përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë. "Që një vit jemi duke diskutuar për procesin më të rëndësishëm që e kemi si shtet, nga ku varet qëndrueshmëria si shtet dhe anëtarësimi në BE. Normalizimi i marrëdhënieve në mes dy shteteve është i pamshangshëm. U bën 20 vjet nga përfundimi i luftës, Kosova dhe Serbia ende nuk kanë arrit një marrëveshje të mirëfilltë që do të arrijte paqen. Besoj fuqishëm në këtë qëndrim se ka ardhur koha që të lëmë prapa armiqësinë dhe të bëjmë marrëveshjen përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Thaçi. Thaçi po ashtu tha se opsioni i ruajtjes së status-quo-s mes Kosovës dhe Serbisë është i gabuar dhe i paqëndrueshëm, pasi është kthim prapa. "Opsioni i ruajtjes së status-quo-s midis Kosovës dhe Serbisë e cila është mbështetur nga disa është treguar i gabuar dhe i paqëndrueshëm, pasi është kthim prapa. Në 12 muajt e fundit ka regres mes Kosovës dhe Serbisë. Përvoja e viteve të fundit ka forcuar bindjen time që ka ardhur koha ta përfundojmë marrëveshjen historike mes Kosovës dhe Serbisë", u shpreh ai. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi thotë se dialogu Kosovë-Serbi është i pamshangshëm, ndërsa idenë për korrigjimin kufijsh e ka marrë nga presidenti i ndjerë Ibrahim Rugova. Në konferencën "Zëri i Popullit rreth finale së madhe të dialogut me Serbinë", Thaçi tha se ka ardhur koha për të lënë prapa armiqësinë, që ka prodhuar tragjedi në Kosovë. "Nuk ka dyshim që nëse këtë vit nuk bëjmë marrëveshje, hyjmë në zonë të rrezikshme dhe destabilizojmë rajonin. Ne nuk mund të kemi garanci më të madhe se zotimi dhe fjalët e SHBA-së". Fatmir Limaj: "Ne nuk duhet të jemi në presionin e kohës, por për një marrëveshje të mirë". Sipas kreut të LVV-së, Albin Kurti, politika kosovare ka mundësi të jetë e unifikuar rreth asaj se çfarë kërkojnë në dialog me Serbinë, ndërsa ka shtuar se askush nuk ka të drejtë t'i falë tokë Serbisë. Sipas sondazhit të RIDEA-së, 62% e të anketuarve nuk pajtohen me ndërprerjen e dialogut Kosovë-Serbi, ndërsa 91% janë kundër ndarjes së veriut të Kosovës. Në bazë të këtij sondazhi 43% e shqiptarëve përkrahin idenë që Kosova të kërkojë bashkimin me Shqipërinë, ndërsa 49 prej tyre janë kundër: 61 për qind e shqiptarëve të Kosovës janë për bashkim me Luginën e Preshevës.

Shtëpia e Bardhë duhet të ndihmojë Anglinë e sapo izoluar.

Brexit do ta bëjë më pak të sigurtë SHBA-në dhe Europën

Largimi nga BE, Britania vë në rrezik ekonominë botërore



për t'u takuar me homologët evropianë; dhe mbështetjen e interesave të përbashkëta me evropianët në OKB, dhe në organizata të tjera ndërqeveritare. Së fundmi, Shtëpia e Bardhë duhet të planifikojë zgjedhjet e politikave, për të ndihmuar një Britani të Madhe të sapo-izoluar. Kërcënimet më të mëdha nuk janë ushtarake, por të natyrës ekonomike dhe diplomatike. Përveç një shoqate të re të tregtisë së lirë, SHBA-të duhet t'i japin Britanisë një politikë më të fortë dypalëshe ushtarake në ushtri; të përshtatin bashkëpunimin e saj në fushën e inteligjencës, për të kompensuar atë që Britania e Madhe do të humbasë nga partnerët e saj të mëparshëm të BE; si dhe të veprojnë si një ndërmjetës e ndershme mes Britanisë së Madhe dhe BE-së, derisa të përfundojë raundi fillestar i zemërimit dhe i hidhërimit të ndërsjellë. SHBA-ja duhet të bëjë gjithçka që mundet, për ta mbajtur të bashkuar këtë grup gjithnjë e më të padiskutueshëm. Por ajo duhet të përgatitet më mirë për rreziqet e sigurisë, që sjell çdo gjë që shpërbëhet. "Bloomberg View" - Bota.al

Londra ka qenë ditët e fundit nën ankth, për shkak të kush-teve jo të përshtatshme, për një vend që mëton se ballafaqohet me një proces të padisiplinuar, për t'u larguar nga Bashkimi Evropian. Debatu ka të bëjë kryesisht me atë se si Brexit, do të ndikojë në marrëdhëniet politike dhe ekonomike midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Evropës. Ajo që është injoruar këto kohë, si nga britanikët ashtu edhe amerikanët, është se Brexit është një humbje tragjike gjeopolitike si për SHBA-në, ashtu edhe për aleancën trans-atlantike. Kur kombet e Europës Perëndimore veprojnë së bashku, ato përfaqësojnë një të katërtën e Prodhimit të Brendshëm Bruto të botës, dhe buxhetin e dytë më të madh të mbrojtjes në botë. Por individualisht, asnjëri nuk është i rëndësishëm si një partner i SHBA-së, sikurse janë kolektivisht. Një thënie e vjetër që i atribuohet Henri Kissingerit, thotë se nuk ka asnjë mënyrë për t'i "telefonuar Evropës", dhe kërkuar ndihmë për politikën e jashtme. Megjithatë, hapat e hedhura gjatë 20 viteve të fundit nga BE-ja - duke përfshirë formimin e një shërbimi diplomatik, dhe një politike të jashtme dhe të mbrojtjes të koordinuar - nisi procesin e sigurimit të atij "numri telefonik", vetëm për të patur kontakte me aleatët më të vendosur të Amerikës. Brexit i vë në rrezik këto arritje, duke tërhequr ekonominë e dytë më të madhe në bllokun evropian nga marrëveshja e tregtisë kontinentale, dhe e shkëputur atë politikisht dhe ushtarakisht nga pjesa tjetër e Evropës. Për më tepër, ajo është një pykë midis Britanisë së Madhe dhe dyshes franko-gjermane, që po dominon gjithnjë e më shumë politikën dhe pozicionet evropiane. Kjo e dëmton aftësinë e Uashingtonit, për të ndërtuar koalicionet koherente që adresojnë problemet e mëdha globale, nga censurimi i Iranit tek vendosja e sanksioneve kundër Rusisë, tek ndryshimet klimatike. Në mënyrë të veçantë për NATO-n, ka, në fakt, një lajm i mirë. Ushtria britanike, e cila tani tentonte të ndante pjesëmarrjen e saj në mes misionëve të BE-së dhe atyre të NATO-s, do të zhvendoset tek kjo e fundit pas Brexit. Lajmi i keq: Kjo do të bënte të mundur që francezët dhe gjermanët, të rrisin mbështetjen e tyre për prioritetet ushtarake të

BE-së, në kurriz të NATO-s. Edhe nëse Brexit, do të kishin një efekt neutral në aspektin e strukturës së forcës ushtarake, ai do ta dobëson të psikologjikisht aleancën. Në fundin më të errët të spekrut, Brexit mund të përshpejtojë rënien e përgjithshme të "projektit evropian", dhe masën e sigurisë që ai ofron. Forca të tjera, përfshijnë zgjedhjen në Itali të një qeverie anti populiste të BE-së; qeveritë antidemokratike në Poloni dhe Hungari, që janë censuruar nga BE; kapitali më i vogël politik i Kancelares gjermane Angela Merkel; dhe protestat në rrugë të Jelekëve të Verdhe në Francë, që minojnë ndjenjat e një Evrope të bashkuar. Çfarë duhet të bëjë SHBA-ja? Së pari, Uashingtoni duhet të qëndrojë mënjanë në debatin britanik. Administrata e Trump, ka qenë paksa mbështetëse e Brexit, duke nënkuptuar se Shtetet e Bashkuara do të sigurojnë në këtë mënyrë një marrëveshje të re dypalëshe tregtare. Por, në fakt, në këtë drejtim, nuk ka pasur hapa konkretë. Kjo është një çështje që duhet të vendoset nga

populli i Britanisë së Madhe. Për sa i përket BE-së, SHBA-të duhet ta mbështesin kudo që mundën - sepse një Evropë e bashkuar, është në interesat e saj gjeopolitike. Masat konkrete, duhet të përfshijnë respektimin e trupit diplomatik të ri të BE-së, dhe njohjen e misionëve të tyre në çështjet botërore; koordinimin me BE-në si një bllok për çështjet kyçe, si programi bërthamor i Iranit dhe mbështetja ndaj terrorizmit; dërgimin e më shumë ushtarakëve amerikanë, të inteligjencës dhe profesionistëve të shërbimit të huaj,

SHKURT

Britania refuzon 19-veçaren e ISIS

4 vjet më parë, Shamima Begum braktisi Britaninë e Madhe për të lindur fëmijë për xhihadistët në tokën e idealeve të saj, Shtetin Islamik në Siri dhe Irak. Por tani që kalifati u zhduk, ajo e ka të pamundur të rikthehet në vendin e saj të lindjes. Autoritetet britanike kanë refuzuar kërkesën e saj për t'u rikthyer. Qeveria në Londër po shqyrtojnë mundësinë e heqjes së shtetësisë së saj. Në një intervistë për BBC, Begum, sot 19-vjeç, thotë se i vjen keq për viktimat e shkaktuara nga terroristët e Shtetit Islamik. E ka kuptuar tashmë se udhëtimi që ndërmori fshehurazi kur ishte 15 vjeç ishte i gabuar. Me vajzën e saj të mitur, ajo jeton tani në një kamp refugjatësh sirianë. Sekretari britanik i Brendshëm, Sajid Xhavid tha se mbi 100 britanikë kanë humbur shtetësinë e tyre pas bashkëpunimit me grupet terroriste.

Hëngri akullore, ndërrojnë jetë 9-veçarja

Një jetë e mitur ka ndërruar jetë, pasi konsumoi një akullore në një hotel në Costa del Sol. Mësohet se 9-veçarja britanike ka gjetur vdekjen, pasi ishte alergjike ndaj qumështit dhe arrave. Sipas mediave spanjolle, e mitura kishte shkuar në hotel së bashku me familjen e saj. Incidenti ndodhi të premten dhe 9-veçarja ndërroi jetë në spitalin Materno Infantil të Malagas. Ajo është dërguar me urgjencë në spitalin e Costa del Sol afër Marbellës, përpara se të transferohej në spitalin e Malagës në një gjendje kritike dhe më pas ka ndërruar jetë. Familja e saj ka kërkuar ditën e martë që vogëlushes t'i bëhet autopsia si dhe analiza të mëtejshme në Institutin e Toksikologjisë në Sevillë për të konfirmuar nëse vdekja e saj është e lidhur me reaksionin alergjik ndaj akullores.

Putin kërcënon amerikanët

Vladimir Putin kërcënoi hapur Shtetet e Bashkuara se do të përballen me raketat ruse nëse amerikanët vendosin sisteme raketash në Europë. Gjatë fjalimit të përvitshëm parlamentar përpara mbi 1 mijë të pranishmëve, shefi i Kremllinit tha se Kremllini nuk do të tolerojë asnjë veprim që cenon sigurinë e Rusisë. Vladimir Putin, president i Rusisë: "Nëse Shtetet e Bashkuara vijojnë të zhvendosin raketat e tyre me rreze të mesme në Europë, ne do të marrim masa duke kërcënuar vendin ku do të vendosen raketat dhe do të shënjestrojmë vendin ku është vendosur përdorimi i këtyre armëve."

PAMJE APOKALIPTIKE NË SIBERI, BIE BORË E ZEZË

Disa qytete në Siberi, në rajonin Kuzbas, ku jetojnë 2.6 milion banorë janë mbuluar nga dëbora e zezë. Ky fenomen vjen si pasojë e fabrikave të përpunimit të qymyrgurit të cilat kanë ndotur ambientin duke bërë që oborret dhe rrugët të mbuluara me dëborë, të zënë shtesë të zezë me pluhur të qymyrgurit. Drejtuesi i një prej fabrikave të qymyrgurit në rajon tha se shkak i kësaj situatë është bërë mosfunksionimi i një prej mburojave që parandalon daljen e pluhurit të qymyrgurit nga fabrika. Ndërsa ambientalistët në rajon janë shprehur se kjo situatë ndodh shpesh në vend por del më në pah kur bie dëborë. "Gjatë pjesës tjetër të vitit nuk mund ta kuptosh një gjë të tillë, por pluhuri i qymyrgurit është shpesh i pranishëm"-janë shprehur ata.

FOTOLAJM

LETRA

Dirigjenti, ministrin Majko: Anuloni samitin e diasporës

Bujar Llapaj nga Kanadaja: Gjashtë arsye pse e refuzoj ftesën për të ardhur

"Harxhimi i 66 milionë lekëve (të rinj) për këtë aktivitet 3-ditor jonormal"

Dirigjenti i njohur Bujar Llapaj përmes një letre të hapur i ka kërkuar ministrin të Shtetit për Diasporën të anulojë Samitin e II që do të mbahet në Tiranë. Ai ka dhënë gjashtë arsye pse nuk e pranon ftesën që i është bërë për të ardhur nga Kanadaja, duke e nisur me një falënderim që Majko votoi kundër shembjes së Teatrit Kombëtar. Mes të tjerash, Llapaj thotë se harxhimi i 66 milionë lekëve (të rinj) për këtë aktivitet 3-ditor i duket i tepër dhe jonormal dhe se duhet të dihej se "çfarë është realizuar nga objektivat e përcaktuara nga Samiti I, në qoftë se ka pasur të tilla dhe jo vetëm fotografi me "udhëheqësit" apo çmallje dhe lot mallëngjimi për Mëmëdheun". Më poshtë letra e plotë e dirigjentit.

LETRA

Bujar Llapaj
Ministrin të Shtetit për Diasporën Z. Pandell Majko
I nderuar zoti ministër,

Para disa ditësh nga zyra juaja mora një email-ftesë për Samitin II të Diasporës.

Fillimisht desha t'ju falënderoj për ftesën dhe duke pasur një konsideratë të veçantë për ju personalisht si një politikan i papërfolur për korrupsion, si një patriot me zemër, si një zë i pavarur edhe kundër të gjithëve si në rastin e votimit të ligjit për shembjen e Teatrit Kombëtar, do të desha publik-



isht t'ju shpreh arsytet përse unë refuzoj të marr pjesë në atë samit, shqip: mbledhje apo kuvend të diasporës.

1. Normalisht në Samitin II duhej të bëhej një analizë se çfarë është

të realizuar nga objektivat e përcaktuara nga Samiti I, në qoftë se ka pasur të tilla dhe jo vetëm fotografi me "udhëheqësit" apo çmallje dhe lot mallëngjimi për mëmëdheun.

2. Edhe pse në Këshillin e Diasporës mund të jenë njerëz vërtetë të shquar në fushën e tyre dhe aktivistë në komunitet, përzgjedhja e tyre nga qeveria e kompromenton qëllimin dhe procesin dhe nuk përputhet me normat demokratike që zbatohen vetë shoqatat e shqiptarëve në mërgim.

3. Harxhimi i 66 milionë lekë (të reja) nga paratë e taksapaguesve shqiptarë për këtë aktivitet 3-ditor, mua më duket e tepërt, jo normale për një shtet me 1001 probleme ekonomike, ku shumë familje shqiptare vuajnë mungesën e bukës për fëmijët dhe do të ishte cinike dhe kriminale që unë apo shumë të tjerë të vijmë dhe kapardisemi nëpër tribuna dhe ekrane.

4. Është hipokrizi dhe cinizëm të ftoh dhe harxhosh miliona për të marrë "mendjen" e diasporës, kur politika shqiptare në përgjithësi dhe ajo "Rilindase" në rastin konkret, nuk kanë nevojë për mendje, por për demagogë dhe servilë. Do ta quaja të singertë këtë kur "udhëheqësit" të dëgjonin dhe shfrytëzonin së pari potencialet intelektuale që jetojnë në Shqipëri. Unë nuk do të pranoja të bëhesha pjesë e një maskarade të tillë.

5. Askush nga politikanët shqiptarë nuk mund të marrë rolin e Skënderbeut dhe të imitojë Kuvendin e tij të Lezhës. 6 shekuj për-

para Skënderbeu i bashkoi shqiptarët nën një flamur, nën një ideal, kurse stërnipat e tij për gati një shekull kanë sunduar popullin e vet me mënyrat nga më barbarët, e kanë përçarë si kurrë më parë për pushtetin e tyre personal, ca në emër të "antikomunizmit", të tjerë për "rilindjen". Në krizën e gjithanshme që gjendet tani Shqipëria pjesëmarrja në këtë samit është thjesht t'i shërbesh si mbështetje "Rilindjes", jo Shqipërisë.

6. Vetë diaspora, përpara se një samiti, kërkon të bëhet realisht ndikuese dhe kontribuuese në proceset demokratike të Shqipërisë, duke iu siguruar e drejta e votës, themeli i së drejtës qytetare. Kur?

I nderuar zoti Majko, ju drejtohem juve si një figurë politike e pakompromentuar jo vetëm e PS-së: do të ishte në nderin dhe respektin e diasporës dhe tuajin personal që ta anuloni këtë Samit.

Duke gjykuar që "Rilindja" është shndërruar në një sekt politikokoekonomik që nuk përfaqëson jo vetëm shqiptarët dhe hallet e tyre, por as PS-në, do të doja që e ju, qoftë edhe i vetëm, të mbeteni tek idealistët e Partisë Socialiste!

Me respekt dhe konsideratë të veçantë,

Bujar Llapaj
Vancouver, Kanada

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Dje në "Reporter.al"

“Forca e Ligjit,” shqiptare apo e huaj?

Nga Besar Likmeta

(vijon nga faqja 1)

... hoteli në zonën e Linzës në periferi të Tiranës, duke prangosur 31 vjeçarin Arkimed Lushaj që qëndronte i shtrirë, gjysmë i zhveshur mbi krevat.

I njohur, gjithashtu, me emrin e artistit 'Stresi', këngëtar i rrymës 'hip-hop' ishte shpallur në kërkim nga Gjykata e Tiranës për armëmbajtje pa leje dhe gjatë arrestimitin iu gjet një pistoletë model 'Beretë' dhe një dozë kokaine.

"Ndalimi i këtij shtetasit u bë pas një hetimi disa mujor në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me metoda speciale të hetimit që janë kryer në funksion të një grupi kriminal që operon në Tiranë në lidhje me aktivitetin e kundërligjshëm me tendencë "Trafikim narkotikësh" dhe "Krimeve kundër personit", deklaroi Policia e Shtetit në një komunikatë për median.

Arrestimi i reperit është një nga 23 aksionet policore të realizuara nga nëntori 2017 në kuadër të operacionit 'Forca e Ligjit' - një njësi speciale e krijuar nga Ministria e Brendshme, e përbërë nga disa agjencitë ligjzbatuese, që ka si qëllim luftën kundër krimit të organizuar, duke shënjestruar grupe kriminale që janë identifikuar dhe operojnë në Shqipëri.

Qeveria e ka prezantuar operacionin 'Forca e Ligjit' si një sukses të madh, duke iu referuar numrit të grupeve kriminale të goditura dhe asetet prej miliona euro të sekuestruara. Megjithatë, një analizë e detajuar e hetimeve të realizuara nga kjo task-forcë speciale e ndërmarrë nga BIRN, tregon që sukcesi i saj është lidhur ngushtë me hetime ose operacione policore të iniciuara nga partnerë dhe organe ligjzbatuese ndërkombëtare.

Sipas ekspertëve të sigurisë ky fakt nuk është për t'u quditur, pasi dobësia për veprimet hetimore komplekse e prokurorisë dhe Policisë së Shtetit është handikap i trashëguar dhe rezultatet e përziera të operacionit 'Forca e Ligjit', thjeshtë e vënë në pah këtë realitet.

Skeptike ndaj task-forcës është shprehur edhe opozita, e cila ka nënvizuar se Policia e Shtetit nuk ka arrestuar peshqit e mëdhenj të krimit ose nuk ka vepruar ndaj kriminelëve që sipas tyre janë të lidhur me Partinë Socialiste në pushtet.

41 grupe kriminale Në nëntor 2017, nën udhëheqjen e ish Ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj, një



numër institucioneve shtetërore krijuan një task-forcë speciale kundër krimit të organizuar. Kjo njësi për luftën kundër krimit të organizuar, përbëhet nga përfaqësues të disa institucioneve, përkatësisht nga: Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria, Policia e Shtetit dhe Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa.

Misioni i kësaj njësie është drejtimi, koordinimi, lehtësimi dhe monitorimi i zbatimit të objektivave në luftën kundër krimit të organizuar. Task-forca mbështetet, gjithashtu, nga disa ekspertë të huaj, nga FBI, Zyra Federale e Policisë Kriminale të Gjermanisë, Koordinatorja e Drejtorisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor, në Ministrinë e Brendshme Britanike, Znj Sarah McAveety, dy ekspertë të posaçëm të Guardia di Finanza dhe Interforcës. Kjo njësi speciale ndahet në një njësi qendrore dhe 11 task-forca rajonale në rrethet kryesore të vendit.

Sipas të dhënave të bëra publike nga Policia e Shtetit, në periudhën nëntor 2017-shtator 2019 kjo njësi arriti të identifikonte dhe të skedonte 41 grupe kriminale që operojnë në Shqipëri, të organizuara me operacione policore kundër 9 prej tyre dhe të bllokonte asetet e krimit të organizuar me vlerë mbi 16 milionë euro.

Megjithatë, të para nga afër, të dhënat tregojnë që operacionet më të mëdha të ndërmarrja nga kjo njësi e krimit të organizuar për

goditjen e grupeve kriminale dhe vënien nën sekuestro preventive të asetëve të tyre, e kanë fillin kryesisht tek bashkëpunimi ndërkombëtar, duke ngritur pikëpyetje mbi aftësinë e organeve ligjzbatuese shqiptare për ndërmarrë hetime proaktive kundër krimit të organizuar - një nga kushtet e Brukselit për hapjen e negociatave me Bashkimin Europian.

Të dhënat e analizuara nga BIRN, tregojnë që nga nëntori 2017 deri në dhjetor 2018, kjo njësi e re kundër krimit të organizuar ndërmori gjithsej 23 operacione policore, duke arrestuar 135 të dyshuar dhe duke shpallur 22 të tjerë në kërkim.

Nga 23 operacione policore të ndërmarrja nga njësi qendrore e task-forcës dhe 11 njësitë vendore të saj, 3 janë operacione ndërkombëtare, 6 sekuestro preventive të bazuara nga ligjin anti-mafia të asetëve të qytetarëve shqiptarë të arrestuar për krim të organizuar jashtë vendit dhe 14 operacione vendore.

Megjithatë, nga 135 të arrestuarit nga njësi qendrore, 68 të dyshuar ose 50% e tyre janë arrestuar si pjesë e tre operacioneve ndërkombëtare të ndërmarrë në partneritet me një duzinë agjencish ligjzbatuese ndërkombëtare në vende partnere.

Sipas të dhënave të Policisë së Shtetit të analizuara nga BIRN, tregojnë se nga operacionet 'Forca e Ligjit' nga nëntori 2017 deri në dhjetor 2018, u vendos sekuestro preventive mbi 4 hotele, 3 kompani, 2 lokale, 2 dyqane, 48 apartamente ose njësi shërbimi, 4 garazhe, 7 automjete, 3 toka truall me sipërfaqe totale 29,110 m2 dhe

një tokë arë pemishte me sipërfaqe 15,500 m2. Këto asetë, të cilat sipas policisë kanë një vlerë mbi 16 milionë euro, janë kryesisht prona të qytetarëve shqiptarë të arrestuar nga vende të BE-së për trafik narkotikësh dhe aktivitetet të tjera kriminale.

Hetimet ndërkombëtare Operacioni me numrin më të madh të arrestuarve, i koduar me emrin 'One if by Land', solli ndalimin e 39 të dyshuarve si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal dhe shpalljen në kërkim të 12 të tjerëve, të akuzuar për kontrabandimin e personave për qëllim emigrimi drejt SHBA-së, Kanadasë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Operacioni i udhëhequr nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe Policia e Shtetit, u organizua në bashkëpunim me agjentët specialë të Shërbimit Diplomatik të Sigurisë të Departamentit të Shtetit në SHBA, Agjencia e Shërbimeve Kufitare të Kanadasë, SELEC, EUROPOL, Interpol, Policia e Kosovës, Policia Kombëtare Spanjolle, Policia Franceze dhe Policia italiane.

Një tjetër operacion i rëndësishëm i task-forcës, operacioni i koduar me emrin 'Precizioni' i zhvilluar në partneritet me autoritetet policore Turke dhe Greke, solli ndalimin e 18 të arrestuarve pjesë të një grupi kriminal të përfshirë në trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Katër nga të dyshuarit - përfshirë dhe kreu i organizatës Met Kanani janë arrestuar në Turqi, ndërkohë pjesëtare të kësaj organizate janë arrestuar më parë në Greqi dhe një tjetër ndodhet në burg në Maqedoni.

Gjithashtu, i rëndësishëm ka qenë operacioni i organizuar nga task-forca në bashkëpunim me autoritetet kroate, gjermane dhe holandeze kundër të ashtuquajturit grupi kriminal 'Bajri', i cili solli 11 të arrestuar si të dyshuar si anëtarë të organizatës kriminale dhe shpalljen në kërkim. Dy prej të dyshuarve u ndaluan në qytetin e Roterdamit në Holandë, ndërsa të tjerët në Shkodër dhe Tiranë.

Sipas Arjan Dyrmishit, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, diferenca midis operacioneve me bashkëpunim ndërkombëtar në krahasim me ato me iniciativë vendore, vë theksin mbi dobësitë e institucioneve shqiptare.

"Ky është një problem që ka ekzistuar gjithmonë dhe nuk shoh që ka një hap cilësor nga ky operacion në këtë drejtim," tha Dyrmishi. "Sigurimi i provës në Shqipëri është i dobët dhe prokuroria jonë nuk është që ka investues që kanë nuhatjen të ndjekin gjurmët e organizatave kriminale, por bazohet në procedurë", -shtoi ai, duke iu referuar organit të akuzës si një 'prokurori sovjetike.'

Sipas Dyrmishit në Shqipëri ka dhe probleme për sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional midis prokurorisë dhe policisë, një tjetër problem që ka penguar goditjet e efektshme ndaj krimit të organizuar.

"Hetimet që vijjnë nga jashtë janë më të qepura", -tha ai. "Ne nuk jemi në nivelin që të kemi goditje gjithëpërfshirëse ndaj grupeve kriminale", -përfundoi Dyrmishi.

Opinion *i* Ditës

Beteja për integrimin

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... të më japë shpresë për ndryshim pozitiv. Por, për fat të keq, sot ajo nuk po e bën diçka të tillë. Ajo është sot në dyert e Parlamentit jo për t'i shërbyer integrimit. Ndoshta mendon se ndodhet aty edhe për këtë, por në fakt nuk po mbron asnjë kauzë të sotme përmirësimi të jetës së qytetarëve të vuajtur të këtij vendi, nëpërmjet integrimit. Dhe nuk ka nevojë të na e thotë raportuesi për Shqipërinë, Knut Fleckenstein në Parlamentin Evropian që të bindemi. Beteja e saj, në formën se si po shpalolet, i bën dëm të pallogaritshëm jo vetëm integrimit, por edhe ekonomisë kombëtare. Nga përshkallëzimi i protestës së saj në rrugë, jashtë Parlamentit dhe duke mohuar veten si pjesë e tij, opozita ngre një furtunë të vërtetë dhe jo false mbi ekonominë tonë. Nis paqëndrueshmëria e mirëfilltë politike e vendit me këtë lëvizje. Prenotimet për vizita turistike në Shqipëri, që në vitin e kaluar na sollën 1.55 miliardë euro dhe që duhet të nisin në mars, do të tkruren për t'u mpakur tmerrsisht. Kush prej nesh që ka shpresuar se dy investimet madhore TAP dhe hidrocentralet mbi lumin Devoll do të mund të gjenin zëvendësues të denjë në investues strategjikë që mund të vinin tek ne, le ta harrojnë. Në këtë klimë, me opozitën të vetëmërguar jashtë jetës normale politike nuk na afrohet askush me rëndësi. Edhe sipër marrja vendëse, megjithëse e mësuar me absurditetet dhe tensionet e kota të garës dhe rivalitetit tonë partiak dhe politik, do ta ketë shumë të vështirë. Sidomos bankat, në një moment kur ky vit 2019 dukej i mbarë për të rritur kredinë për bizneset dhe qytetarët. Nëse opozita vijon betejën në rrugë duke mohuar qenien e saj në Parlament me djegien e mandateve, brenda këtij viti shifra e kapitalit të munguar nga turizmi, investimet e huaja të munguara dhe investimet vendëse e kredia për ekonominë



ngjitet në afro 1 miliard euro! Kjo humbje e stërmadhe do t'i shtohet kalendarit të trishtë të shanseve të djegura të integrimit të Shqipërisë. Në vitin 1996, 23 vjet më parë, kishim shumë gjasa të ecnim mirë me afrimin për në Bashkimin Evropian, për të fituar që atëherë pozicionin e vendit kandidat për në BE. Por ndodhi viti i mbrapshtë 1997 dhe i dogjëm shanset për integrim, duke u kthyer mbrapa të paktën dhjetë vjet. Në vitin 2011 po ecnim mirë si ekonomi, në mes të gjullurdisë së krizës botërore financiare dhe ekonomike që kishte kapluar Eurozonën dhe Brukselin na shikonin me simpati nga këndvështrimi ekonomik. Por opozita (në atë kohë socialiste) kapi bulevardin në Tiranë dhe ndërtoi një çadër me rreshta tavolinash. Në Bruksel u ankua për njëqind e një të pabërat e qeverisjes dhe u desh darka në restorant "Krokodili" që të qetësoheshin disi gjakrat. 6 vjet më vonë ishte Partia

Demokratike që hyri në çadër dhe refuzonte çdo provë të Brukselit për bisedime që të futej në zgjedhjet e qershorit 2017. U deshën tri orë magjike të natës së 17 prillit 2017 mes drejtuesve të pozitës dhe opozitës, që integrimi të mos pësonte një goditje fatale me opozitën jashtë garës zgjedhore. Sot, më pak se dy vjet më vonë, me reformën në drejtësi që dalëngadalë ka marrë formë, duke na shtuar gjasat për integrim, kanosja opozitare bëhet më e rëndë. Jo vetëm nuk mendon të garojë në zgjedhjet vendore katër muaj më vonë, por del jashtë Parlamentit, për të vijuar të përfaqësojë të 675 mijë zgjedhësit e saj... në rrugë. Sikur të bëhej një vrojtim në këto momente mes zgjedhësve të dy partive kryesore opozitare, se si e gjykojnë ata që votat që u kanë dhënë këtyre partive ato të vijojnë t'i përfaqësojnë në politikën e rrugës, si zor që shumica e tyre ta miratojnë një zgjedhje të tillë. Qytetari i thjeshtë është si natyrë

krejtësisht kundër shtimit të tensionit dhe të pasigurisë, kur nuk ka arsye të mjaftueshme për të përmbysur sistemin (kryer revolucion). Zgjidhja revolucionare paraqitet si alternativë kur demokracia ka pushuar së funksionuari. Mirëpo në këtë shtetin tonë, të kapur nga oligarkët dhe ku ndikimi i elementëve me të kaluar ose dhe të tashme kriminale është i pranishëm, ende merr frymë demokracia. Ajo rri e trullosur, po të duam, herë-herë edhe e mpirë, por nuk është mbytur akoma. Dhe nuk ka shanse të mbytet, me gjithë trysinë. Prandaj lind pyetja: a ia vlen të paguajmë një faturë 1 miliard euro duke shpërdoruar shanset tona për zhvillim ekonomik dhe të hedhim me tuç në tokë gjasat për integrim? Përgjigjja është jo! Beteja për zhvillim dhe për integrim duhet të vazhdojë në kushte normale (me gjithë defektet e mëdha të demokracisë sonë), dhe jo revolucionare.

HOROSKOPI

DASHI

Kjo ditë mund t'ju ofrojë surpriza të këndshme në dashuri. Nëse nuk arrini të kapni mundësitë që ju ofrohen, do të dilni i zhgënjyer. Në punë tregohuni më i vendosur dhe më i repret në kërkesat tuaja.

DEMI

Në dashuri do të dominoheni nga ndjenjat e forta. Në punë reflektoni më mirë ndaj asaj që ju rrethon, si dhe analizoni kërcënimet e mundshme, sidomos nga disa persona që nuk kanë ndjenja pozitive ndaj jush.

BINJAKET

Sa i takon raportit në çift, parashikohen momente tensioni. Përpiquni të ruani qetësinë, në mënyrë që të shmangni mosmarrëveshjet. Në punë do ju duhet të bëni një hap prapa, për shkak të një keqkuptimi.

GAFORJA

Në sferën profesionale do të përballeni me një surprizë, ndaj mundohuni të jeni të përqendruar, në mënyrë që të mos e humbni. Një nxitim i juaj në dashuri mund të shkatërojë gjithçka.

LUANI

Duhet të tregoni sa vleni realisht në profesionin tuaj, duke nxjerrë në pah idetë që ken. Në raportin në çift nuk parashikohen zhvillime të reja. Me financat, gjërat do shkojnë shumë mirë.

VIRGJERESHA

Shmangni xhelozitë ndaj partnerit. Nuk zgjidhni asgjë me ndjesitë negative, përkundrazi, dëmtoni shëndetin. Mendoni pozitivisht dhe do të shikoni sa mirë do të ecë gjithçka, veçanërisht në dashuri.

PESHORJA

Përpiquni të jeni më i hapur ndaj miqësive të reja. Koha më pas do të qartësojë mendimet në lidhje me secilin prej tyre. Në sferën profesionale, parashikohet ngritje në detyrë dhe shpërblim për përkushtimin.

AKREPI

Kjo ditë do të jetë e mbushur me lajme pozitive në aspektin profesional. Eprorët tuaj kanë opinion pozitiv ndaj jush. Në dashuri ka një ngecje, por kjo jo për fajin tuaj. Është aspekti planetar që nuk ju favorizon në këto momente.

SHIGJETARI

Mot i mirë shikohet që në mëngjes. Kjo ditë do të jetë pozitive. Nuk do të ketë diçka konkrete, por gjendja shpirtërore do të jetë mjaft e mirë. Kjo tregon se nuk nevojiten gjërat për t'ju bërë të lumtur.

BRICJAPI

E mira do t'ju shpërblehet me të mirë. Mos hiqni dorë nga ndihma ndaj të tjerëve. Është ndjesia më e mirë që mund të merrni ndonjëherë. Sa i përket dashurisë, ndonjë flirtim mund të dalë gjatë ditës.

UJORI

Tregohuni më i fokusuar në punën tuaj, ose në shkollë. Mos lini pas dore disa detyra të rëndësishme, sepse mund t'ju mblidhen shumë angazhime, që më pas nuk do të dini si t'ia dilni mbanë me sukses.

PESHQIT

Nëse jeni duke menduar për të realizuar një udhëtim, shtyjeni atë për një moment tjetër. Përpiquni të mos shpërqendrohni nga prioritetet tuaja, të cilat kanë nevojë për një hov cilësor.

REAGJONË BARDHEBLUTË



Pas vendimit të fundit të Komisionit të Disiplinës, që ndëshkoi me 300 mijë lekë të rinj klubin e Tiranës për sjelljen e tifozërisë bardheblu në takimin e fundit kundër Luftëtarit, ka reaguar menjëherë klubi kryeqytetas, që ka kritikuar tifozërinë e saj për reagimet e shëmtuara dhe ka kërkuar më shumë sportivitet. Kjo sepse ndeshja e radhës

Tirana: Kërkojmë ndjesë publike për sjelljen e tifozëve

brenda do të jetë derbi kundër Partizanit dhe pasojat mund të jenë më të rënda në rast të një sjellje të ngjashme. "Klubi i Futbollit Tirana kërkon ndjesë për sjelljet e pahijshme të disa tifozëve në ndeshjen e fundit Tirana - Luftëtari,

takim i zhvilluar në stadiumin "Selman Stërmasi". Sendet dhe shishet e ujit të hedhura në fushë, janë kundër çdo vlere të komunitetit bardheblu. Klubi bën apel për të ruajtur qetësinë, sportivitetin dhe vlerat qytetare në stadium.

Gjobat, mbyllja e deryve të tribunave apo dhe dëmtimi i stadiumit, paralizojnë klubin dhe cilindo prej tifozëve që pret të jetë çdo fundjavë pranë skuadrës. Këto sjellje të përsëritura duhet të mos rikthehen më në stadium, aty ku skuadra meriton të përkrahet dhe duartrokitet," lexohet në komunikatën zyrtare të bardhebluve.

Mesfushori që ka luajtur për të dyja skuadrat bën vëzhgimin e kryendeshjes së javës së 23-të



Jeton Selimi

Fagu: Skënderbeu-Tirana do ta vendosin mesfushat

Ish-lojtari: Kampion dua Teutën, por Partizani...

Skënderbeu-Tirana është ndeshja hapëse e javës së 23-të të Superiores. Nuk pritet të jetë një ndeshje aq e nxehtë si vitet e fundit, pasi dy skuadrat janë larg objektivit në kampionat, por përsëri mbetet një sfidë interesante, ku edhe tifozëria do të ketë rolin e vet. Mes shumë lojtarësh që kanë luajtur për të dy ekipet është edhe Erxim Fagu, i tërhequr nga futboli për shkak të një dëmtimi të pësuar në kulmin e karrierës, kur mbante fanellën e Skënderbeut. Në një intervistë për "Vipsport.al", ai analizon këtë ndeshje dhe thekson se ajo do të vendoset nga mesfushat, pasi aty do të përqendrohet loja. Fagu evidenton Krasniqin si lojtarin që mund të bëjë diferencën, ndërsa për Tiranën beson se mund të fitojë Kupën e Shqipërisë.

Skënderbeu dhe Tirana ndeshen për herë të tretë në këtë kampionat, në një situatë jo të mirë për të dy ekipet, larg objektivave të sezonit. Çfarë ndeshje parashikon të premen në Korçë?

Te dyja skuadrat vijnë nga rezultate jo të mira dhe



të dala nga objektivi i fillimit të sezonit. Gjithsesi, do të jetë një ndeshje e bukur për t'u parë, pasi këto skuadra gjithmonë kanë dhuruar ndeshje spektakolare, pavar-

ësisht situatave. E shikoj Tiranën disi me të avantazhuar, pasi kanë një rritje nga fizike dhe psikologjike. Skënderbeu duket tashmë se ka rënë në gjendje "kome"

dhe duket sikur e ka të vështirë të marrë veten.

Duke pasur parasysh organikën aktuale të dy skuadrave, cilët lojtarë mund të jenë faktor në këtë

ndeshje?

Po të shikosh të dyja skuadrat, nuk është se kanë ndonjë lojtar, i cili ka aftësitë që ta marrë grupin për dore dhe ta udhëheqë, por mendoj që faktori që do të ndikojë në këtë ndeshje, do të jenë repartet e mesfushës, pasi aty dhe do të përqendrohet më shumë loja. Por, nëse do të flisnim për një lojtar, Krasniqi mund të jetë ai që do të bëjë diferencën në këtë ndeshje.

Sa ndikon faktori-fushë për Skënderbeun, që luan në fushën e tij dhe ju e keni provuar atmosferën e atij stadiumi?

Me thënë të drejtën, faktori fushë për Skënderbeun ndikon shumë, pasi dihet që ka një tifozëri të zjarrtë. Shpresoj shumë që stadiumi të jetë i mbushur plot, si në vitet e kaluara, pasi një ndeshje e tillë pa tifozë nuk do të kishte kuptim.

Si ju duket Shehi si tra-

jner, me të cilin keni qënë shok ekipi?

Shehi është një trajner i ri, ashtu sikurse edhe Shkëmbi. Të dy janë duke bërë mirë. Shehi, që kur ishte akoma në aktivitet si futbollist, e kish të mishëruar stofin e trajnerit, pasi gjithmonë ka qënë krah për të gjithë trajnerët. Sigurisht që është komplet tjetër gjë nga të qenit lojtar, por kam besim se Shehi do të jetë një nga trajnerët e mirë në qarkullim.

Po Mema?

Memën e kam pasur zvtrajner te Tirana dhe mund të them të njëjtat fjalë si për Shehin, por avantazhi i Memës është që ka disi më shumë eksperiencë në stol.

Çfarë avantazhesh kanë skuadrat ndaj njëra-tjetrës në këtë ndeshje?

Avantazhe nuk është se shikoj shumë në këtë ndeshje, pasi të dyja skuadrat kanë problemet e tyre, por ajo që mund të them është që skuadra që do të jetë më e saktë dhe më e qetë në këtë 90-minutësh, do të marrë rezultate pozitive.

Ku i sheh këto dy skuadrat në fund të sezonit?

Për sa i përket pyetjes tuaj, mendoj që Tirana duhet të tentojë për fitimin e Kupës, ndërsa Skënderbeu e shikoj larg realizimit te objektivave të vendosura në fillim të sezonit.

Cilin ekip voton Erxim Fagu për titullin kampion?

Është akoma herët për të thënë se kush mund të jetë fitues i kampionatit. Do të kisha dëshirë që Teuta të dilte kampione, pasi ka tentuar disa herë, por nuk ia ka arritur qëllimit. Por do të jetë shumë e vështirë me këtë Partizan, që është vërtet i fortë dhe ka më shumë stabilitet se skuadrat e tjera.

ANALIZAT

Interi tërbohohet me Ikardin: nuk është i dëmtuar




dhe sot, analizat i kanë dhënë të drejtë klubit. Ikardi nuk është i dëmtuar, por ka zgjedhur t'i bëjë bisht skuadrës për t'u mos u përballur me shokët, të cilët ishin dakord me gradimin e Samir Handanoviç si kapiten të ekipit. Tashmë e ardhmja e Ikardit tek Interi është veç një pikëpyetje e madhe, me tifozët që kanë dalë kundër idhullit të tyre.

TIFOZI ISHTE I DEHUR

E rrallë, iku në Mynih, ndeshja luhej në Liverpool

Kush e di se çfarë do të ketë menduar Pol, tifoz i Liverpoolit, kur e ka kuptuar se ndodhej në vendin e gabuar në momentin e gabuar. Është një ndeshje si që shumë prej nesh e përjetojnë, por ta përjetosh në 1/8-at e Championsit mes Liverpoolit dhe Bajernit, është diçka shumë e rrallë. Këtë gabim, Pol nuk do të dëshironte kurrë ta bënte, por tashmë është diçka që do ta kujtojë përgjithmonë. Dhe e ka shpjeguar për një televizion gjerman. "Duke festuar kisha pirë ca birra më shumë, dhe pasi sigurova biletat për ndeshjen e parë, prenotova udhëtimin për në Mynih, i bindur se ndeshja luhej aty. Nuk e kisha kuptuar se ndeshja e parë do të luhej në Liverpool". Ai ishte në Mynih, i karikuar për ndeshjen. Mëkat që luhej në "Anfield". Tashmë i mbetet që të mos bëjë të njëjtin gabim më 13 mars për ndeshjen e kthimit. Mjafton të qëndrojnë në Mynih.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Niven që qe aktor.
7. Little... kryeqyteti i Arkansas.
7. Janë tek në lakër.
10. Nuk ka akoma një bebe.
11. Kufizojnë katete.
12. Penn aktor.
13. Hector që shkroi Pa familje.
15. Thahen me bonifikime.
18. Mbyllin takimin.
19. Ndërmarrje Industriale Mat.
21. Mbyllën me epilog.
23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
25. Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
27. Njëlljo për latinët.
30. Eshhtë vend si Katari.
31. Pupi regjisor.
32. Janë strehat e çobanëve.
33. Eshhtë centrali si Chernobyl.
35. Fillojnë një argument.
36. Të parat në stadium

37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërore.
42. Thirrej edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshhtë syzë... në komo.

VERTIKALI

1. Hyskja aktor.
2. Kush e thotë lutet.
3. Një tis mjegulle.
4. Maiden që këndojnë.
5. Gjysmë rekord.
6. Antonio skulptor i famshëm.
7. David regjisor.
8. Janë brinjë në skuadër.
9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.
16. Qureshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitarë e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si goja.
28. Pak daktilografi
29. Eshhtë si divan.
31. Një pjesë e amerikanëve.
32. Bernhardt që qe aktore.
34. Eshhtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak marramendëse.
43. Eshhtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. E bardhë ajo Moby Dick.
5. Fillojnë amplifikimin.
7. Eshhtë vit që parashikohet.
10. Mbyllin pamjen.
11. U printë jeniçerëve.
13. Thurman aktore.
14. Një reaksion në provëz.
16. Një sport me brez të zi.
19. Në fund të fundit.
20. Janë në gjyq.
23. I është hequr të dënuarit.
24. Eshhtë shahu i fundit
25. Janë fletë trëndafil.
27. Kufizojnë një metër.
28. Tregojnë pallate në miniaturë.
29. Një fjalë pa shkak.
30. Janë përlogaritje.
32. Mbyllin një dritare.
33. Të parat në muzg.
34. Me të nxjerrin një letër.

VERTIKALI


35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balesinë.
39. Inicialët e Reimman regjisor.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Diftong në dietë.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.
7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përrallat e vëllezërve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshhtë medalja e të parit.
21. I dhimbset frikacakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshhtë llahatar.
28. Janë inate të akumuluar.
30. Eshhtë vëllia i gruas.
31. Një tip për të këcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akiilin.
43. Kodi i celularit.
45. Mbledh basket separatistë
47. Një është edhe Egjeu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

			5						
	5	7		6	9				
					2	9			6
			8				4		
4	9	2		1	5				
5	6	8							
				4					
7		9							3
1		5		8	7	4			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	6	3	5	7	9	8	4	1
4	5	8	3	1	2	7	6	9
7	9	1	4	6	8	2	3	5
9	3	2	8	4	6	1	5	7
1	4	5	9	2	7	3	8	6
6	8	7	1	5	3	4	9	2
3	2	9	6	8	1	5	7	4
8	7	4	2	9	5	6	1	3
5	1	6	7	3	4	9	2	8

Argëtim filozofik

- Shpirti melankolik rrit mjerinë, ndërsa një buzëqeshje e lumtur shpesh shpërndan mjegullën që predikon stuhinë.

- Argumentet serioze të kundërshtantit t'i refuzoni me humor, ndërsa shakatë, seriozisht.

Kushdo që do, shpreson, kushdo që shpreson pret, kushdo që pret këmbëngul, kushdo që këmbëngul fiton.

- Lëreni heshtjen tuaj t'u flasë të gjithë atyre që nuk dëgjuan dhe nuk respektuan kurrë fjalët dhe veprat tuaja.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T	H	A	R	K	D	B	M	I	K		
D	I	A	B	E	T	I	D	E	T	I	A	B	I	B	I	M	O	R	E	A	
R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T	R	O	S	S	L	A	R	R	O	M	
F	E	N	I	M	O	R	E	T	R	A	N	A	D	E	R	I	M	I	A		
F	E	K	O	N	O	M	I	A	D	B	E	H	E	M	A	T	O	M	A	T	
R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E	E	H	A	B	A	N	E	R	A	A	
A	N	T	E	N	A	T	A	A	B	L	E	R	A	E	A	N	E	T			
N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A	A	R	B	I	T	E	R	L	G		
K	N	E	I	I	L	I	R	E	T	T	A	R	A	N	S	A	R	T			
I	B	A	N	A	K	A	E	T	K	A	N	T	A	T	A	T	R	A			
B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D	A	I	A	G	A	B	A	R			
E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I	B	I	K	B	R	A	D	B	E		

- - Aftësia mund të të çojë në krye, por vetëm karakteri mund të të mbajë lart atë.
- - Kemi mjaft kontroll mbi armët. Ajo që na duhet është kontrolli mbi idiotët.
- - Mënyra se si e jepni, është më e rëndësishme se ajo që jepni.

- - Ndonjëherë duhet të harroni atë që ndjeni dhe të kujtoni atë që meritoni.
- - Nëse sot nuk bëj asgjë për ty, është sepse dje bëra gjithçka që mundat!!
- - Kur ndaloni të jeni të interesuar për atë që të tjerët mund të mendojnë për ju, do të filloni të jetoni fiziologjikisht

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

O	R	A	K	U	L	L	I	F	R	A	G	U
P	A	T	R	I	O	T	K	I	L	M	E	R
E	L	I	A	F	O	R	A	R	I			
R	E	F	V	I	K	T	I	M	A	T	M	A
A	M	A	R	R	E	Z	I	T	E	A	H	
M	E	T	E	O	R	I	T	E	T	H		
R	O	M	A	N	T	I	K	E	T	M	A	E
E	T	O	E	O	T	K	A	T	E			
P	O	R	T	N	A	T	E	N	I	P		
A	R	I	A	E	L	E	O	R	I			
R	E	A	L	E	T	O	T	A	L	E		
T	T	L	E	S	T	E	T	I	K	A		
T	A	T	A	I	M	D	O	R	E	A		
U	R	A	T	P	A	P	A	O	D	E	T	
N	E	R	E	U	K	O	L	M	L	O		
E	N	E	N	D	A	L	I	L	A	I	O	
L	E	E	M	A	R	A	D	O	N	A	S	
I	P	R	O	V	O	K	A	T	O	R	F	
V	I	O	L	I	N	E						
M	A	T	E	L	D	A	N	A	D	A	R	
A	L	E	A	T	K	O	F	I	N	T		
K	T	A	B	L	V	D	I	K				
S	H	E	M	R	A	B	E	R	O	T	I	K
I	N	T	R	I	G	A	A	L	T	U		

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

